



Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE 15 korrik 2020

Misioni i Posaçëm i ODIHR-it për Vlerësimin e Zgjedhjeve
Raporti përfundimtar



Varshavë
2 tetor 2020

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE.....	1
II.	HYRJE DHE MIRËNJOHJE	4
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE	5
V.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE.....	8
VI.	REGJISTRIMI I VOTUESVE.....	11
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE.....	13
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE	14
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS	17
X.	MEDIAT.....	20
	A. AMBIENTI MEDIATIK.....	20
	B. KORNIZA LIGJORE	21
	C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE.....	24
XI.	VËZHGESIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË	25
XII.	KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT	25
XIII.	DITA E ZGJEDHJEVE.....	28
	A. VOTIMI I HERSHËM	28
	B. VOTIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE.....	29
	C. NUMËRIMI, NXJERRJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE PARAPRAKE	30
XIV.	REKOMANDIME.....	31
	A. REKOMANDIMET PRIORITARE	32
	B. REKOMANDIME TË TJERA.....	33
	SHTOJCË: REZULTATET PËRFUNDIMTARE	36
	RRETH ODIHR-IT.....	37

REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
15 korrik 2020

Raporti përfundimtar i Misionit të Posaçëm të ODIHR-it për Vlerësimin e Zgjedhjeve ¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës nga autoritetet e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) krijoi një Mision të Posaçëm për Vlerësimin e Zgjedhjeve (MPVZ) për zgjedhjet e parakohshme parlamentare që u mbajtën më 15 korrik. MPVZ-ja rifilloi procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve filluar nga Misioni për Vëzhgimin e Zgjedhjeve i ODIHR-it (MVZ), i cili u pezullua në 17 mars pas futjes së kufizimeve për udhëtimet ndërkufitare në gjithë rajonin e OSBE-së për shkak të përhapjes së sëmundjes së koronavirusit (KOVID-19) në vitin 2019.² MPVZ-ja e ODIHR-it vlerësoi nëse procesi zgjedhor u zhvillua në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin e vendit.

Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake e publikuar më 16 korrik doli në përfundimin se zgjedhjet e parakohshme parlamentare “u administruan në përgjithësi në mënyrë efektive mes përshtatjeve të ndërmarra në përgjigje të pandemisë së KOVID-19, por stabiliteti ligjor u cenua nga rishikimet thelbësore të Kodit Zgjedhor dhe të rregulloreve pasuese *ad hoc* të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Megjithëse me ton negativ, fushata zgjedhore ishte vërtet konkurruese dhe pjesëmarrësit mundën t’i përcillnin mesazhet e tyre pavarësisht kufizimeve në komunikimin tradicional. Mbulimi mediatik i zgjedhjeve pati një mungesë të vlerësimit kritik të platformave, ndërsa dispozitat lidhur me reklamat e paguara politike favorizuan tre partitë më të mëdha. Dita e zgjedhjeve kaloi pa probleme, pavarësisht sfidave teknike në publikimin e rezultateve dhe shqetësimeve në lidhje me regjistrimin e votuesve.”

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u caktuan fillimisht të mbaheshin më 12 prill të vitit 2020, por procesi zgjedhor u pezullua më pas për shkak të pandemisë së KOVID-19. Gjendja e jashtëzakonshme e shpallur nga presidenti më 18 mars, fillimisht për 30 ditë, u zgjat katër herë dhe zgjati deri më 22 qershor. Data e zgjedhjeve të 15 korrikut u përcaktua pas negociatave të gjata mes partive politike në lidhje me nevojën për të rikrijuar një qeveri dhe kuvend të përhershëm dhe për të marrë masa sigurie për mbajtjen e zgjedhjeve gjatë periudhës së pandemisë.

Zgjedhjet u zhvilluan në bazë të kornizës ligjore që u ndryshua thelbësisht në prag të shpalljes së zgjedhjeve, në kundërshtim me praktikat e mira ndërkombëtare. Ndryshimet e paraqitura adresuan vetëm pjesërisht disa rekomandime të ODIHR-it, ndërsa rekomandimet e hershme në lidhje me ndryshimin e kufijve të njësive zgjedhore nga një organ i pavarur, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, universalitetin dhe barazinë e votës në njësinë zgjedhore jashtë vendit, dhe kontrollin efektiv të financimit të fushatës mbeten të patrajuara. Mospërputhjet e vazhdueshme, zbrazëtitat dhe formulimet e paqarta nënvizojnë nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të kornizës ligjore zgjedhore një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të ardhshme.

Administrata zgjedhore, e përbërë nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ), Komisionet Zgjedhore Komunale (KZK) dhe Këshillat Zgjedhore, funksionuan në mënyrë kryesisht profesionale

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Janë siguruar edhe përkthime jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën shqipe.

² Shih [raportet e mëparshme të ODIHR-it për zgjedhjet në Maqedoninë e Veriut](#), duke përfshirë edhe [raportin e përkohshëm të 30 prillit 2020](#).

pavarësisht nga ndërlikimet e shkaktuara nga pezullimi i procesit zgjedhor, gjendja e jashtëzakonshme dhe përshtatjet e nevojshme për shkak të pandemisë së KOVID-19. KSHZ-ja i përmbushi detyrat e saj brenda afateve ligjore dhe në një mënyrë mjaft transparente. Besimi i publikut në administratën zgjedhore u dëmtua pjesërisht nga sfidat teknike në publikimin e rezultateve.

Autoritetet ndërmorën një sërë masash për ta përshtatur procesin zgjedhor me sfidat e pandemisë së KOVID-19. Një ditë shtesë e votimit të hershëm u vendos për të mundësuar votimin e zgjedhësve pozitivë ndaj KOVID-19 dhe të atyre në vetë-izolim. KSHZ-ja miratoi udhëzime, ku përshkruheshin protokollat shëndetësore për fazat e ndryshme të procesit zgjedhor, si dhe u rishikuan hapësirat e vendotimeve për të mundësuar kërkesat për distancim fizik. KSHZ-ja gjithashtu zhvilloi një fushatë gjithëpërfshirëse të edukimit të zgjedhësve mbi rregullat e përshtatura në aspektin shëndetësor për zbatimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve.

Çështjet e hershme strukturore që lidhen me regjistrin e votuesve, si mungesa e standardizimit të të dhënave të adresave, harmonizimit dhe ndërveprimit mes institucioneve, si dhe mungesa e udhëzimeve të hollësishme mbi procedurat e regjistrimit të votuesve mbeten të patrajtuara. Megjithatë Kodi Zgjedhor i ndryshuar parashikoi Regjistrin Qendror të Popullsisë si një burim të ri për regjistrin e votuesve, ai nuk mundi të përdoret për këto zgjedhje për shkak të të dhënave jo të plota. Kapaciteti i kufizuar i TI-së i KSHZ-së, i kombinuar me një mungesë të kohëve të fundit të një kontrolli gjithëpërfshirës të cilësisë, ndikuan më tej në cilësinë e regjistrimit.

Regjistrimi i kandidatëve përfundoi para pezullimit të zgjedhjeve, në një proces gjithëpërfshirës. Për t'u vlerësuar është fakti që KSHZ-ja nxori disa udhëzime, të cilat ofruan një listë të dokumenteve të nevojshme për kandidatët dhe hollësitë e procedurës së verifikimit, krijoi një aplikacion të ri online për paraqitjen e listave të kandidatëve dhe publikoi të gjitha listat e kandidatëve në uebfaqen e saj me një mjet interaktiv, i cili shfaqte përkatësinë partiake, gjininë, njësinë zgjedhore dhe komunën e kandidatëve. Gjithsej 12 parti politike dhe 3 koalicione paraqitën 1.598 kandidatë në 78 lista. Në të përfshiheshin 675 kandidatë gra (42 për qind) dhe gratë kryesonin 19 nga 78 lista gjithsej. Këta kandidatë vazhdonin të ishin të regjistruar në momentin që procesi zgjedhor rifilloi pas gjendjes së jashtëzakonshme.

Dukshmëria e kandidateve femra mbeti e ulët. Megjithatë gratë përbënin 42 për qind të kandidatëve të regjistruar, monitorimi i MPVZ-së së ODIHR-it tregoi se mbulimi mediatik i grave politikane ndryshonte midis vetëm 4 dhe 14 përqind të mbulimit të kandidatëve. Kandidatet gra me të cilat u takua MPVZ-ja e ODIHR-it përshkruan mungesën e mbështetjes për gratë e mundshme lidere në strukturat e brendshme partiake.

Fushata u karakterizua nga një retorikë negative dhe sulme personale mes kryetarëve të partive, në dëm të një debati thelbësor. Dalja e një sërë regjistrimesh të fshehta të liderëve politikë kontribuoi edhe më shumë në tonin negativ. Pandemia e KOVID-19 e ndryshoi ndjeshëm stilin e fushatës, pasi një sërë dekretesh qeveritare përcaktuan masat e sigurisë që duhen zbatuar në takimet publike. Partitë i zëvendësuan tubimet tradicionale me takime të vogla dhe vizita të kufizuara derë më derë. Pavarësisht rrethanave, partitë i zhvilluan fushatat në mënyrë aktive dhe patën mundësi që t'i përcillnin mesazhet e tyre. MPVZ-ja e ODIHR-it vërejti raste të izoluara ministrash nga parti të ndryshme që i përzien funksionet e tyre shtetërore me aktivitetet politike. Pati gjithashtu parti politike që i raportuan MPVZ-së së ODIHR-it për disa raste presioni ndaj zyrtarëve publikë, veçanërisht në përfundim të vendit, duke përfshirë edhe përpjekjet për instrumentalizimin e policisë.

Korniza ligjore për financimin e fushatës kërkon një harmonizim të mëtejshëm për të eliminuar zbrazëtit dhe mospërputhjet. Institucionet që kanë për detyrë të bëjnë mbikëqyrjen e financimit të fushatës kanë mungesë të kapacitetit për shkak të buxhetit të pamjaftueshëm dhe mungesës së burimeve

njerëzore, gjë që e dëmtoi kontrollin e tyre mbi llogaridhënien dhe transparencën e financimit të fushatës. Shumica e partive politike e vlerësuan kornizën për raportimin e ndërmjetëm si të tepërt dhe të ngarkuar, dhe jo të gjithë garuesit i paraqitën të gjitha raportet e ndërmjetme, pavarësisht kërkesave ligjore. Duke qenë se KSHZ-ja nuk i publikonte vazhdimisht raportet e garuesve dhe raportet e palëve të treta nuk u publikuan, mungonte transparenca.

Të gjithë bashkëbiseduesit MPVZ-së së ODIHR-it vërejtën se përmirësimet e konsiderueshme në lirinë e mediave në vitet e fundit nuk u mbështetën me reforma sistematike në sektorin e mediave, siç është sigurimi i neutralitetit politik të transmetuesit publik dhe organit rregullator të mediave. Korniza ligjore për ndarjen e fondeve për kohën e paguar për reklamë, si dhe shpërndarja e limiteve maksimale për reklamat e paguara politike, u modifikua me një dekret qeveritar të miratuar më 22 qershor, ditën e fundit të gjendjes së jashtëzakonshme. Dispozitat favorizuan tre partitë më të mëdha, të cilave së bashku iu dhanë ligjërisht shuma dhe alokime të kohës disa herë më të mëdha se dymbëdhjetë garuesve të tjerë së bashku. Gjatë periudhës zyrtare të fushatës, të gjithë transmetuesit kombëtarë tokësorë e përqendruan kryesisht mbulimin e tyre në akuzat e ndërsjella mes liderëve të partive kryesore politike, ndërsa raportimi i thelluar analitik ose diskutimet për politikat kryesisht mungonin.

Shumica e ankesave në lidhje me zgjedhjet janë në kompetencën e KSHZ-së, përveç ankesave që lidhen me fushatën, financimin politik dhe keqpërdorimin e burimeve administrative, të cilat janë në kompetencën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK). KSHPK-ja konstatoi shkelje në dy nga gjashtë kundërshtimet që pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore, njëra prej të cilave në fund u rrëzua nga Gjykata Administrative pas ankesës. KSHZ-ja i hodhi poshtë të gjitha kundërshtimet për zhvillimin e hershëm të fushatës, si dhe kundërshtimet mbi parregullsitë zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve se nuk ishin të mbështetura me prova ose se ishin të papranueshme duke qenë se shkelja e pretenduar kishte ndodhur gjatë gjendjes së jashtëzakonshme që çoi në pezullimin e procesit zgjedhor. Kompetenca e re e ushtruar nga KZK-të për t'i shqyrtuar kundërshtimet gjatë votimit të hershëm dhe në ditën e zgjedhjeve rezultoi në juridiksion të dyfishtë me KSHZ-në për disa kundërshtime, dhe disa kundërshtime të ditës së zgjedhjeve mbetën të pashqyrtuara nga KSHZ-ja. Kufizimet në të drejtën për të kontestuar parregullsitë dhe rezultatet zgjedhore, si dhe qasja formaliste ndaj shqyrtimit të kundërshtimeve, nuk siguruan një mjet juridik efektiv.

MPVZ-ja e ODIHR-it nuk realizoi një vëzhgim sistematik dhe gjithëpërfshirës të votimit të hershëm dhe të procedurave të ditës së zgjedhjeve, megjithëse më 15 korrik vizitoi një numër të kufizuar vendvotimesh. Votimi i hershëm dhe vetë dita e zgjedhjeve kaluan në përgjithësi në mënyrë të rregullt, pa incidente të mëdha ose tensione. Në natën e zgjedhjeve, KSHZ-ja raportoi një sulm kibernetik, që rezultoi në prishjen e uebfaqes së KSHZ-së. Publikimi i rezultateve të zgjedhjeve u ndikua nga sfidat teknike. KSHZ-ja bëri një nxjerrje shtesë të rezultateve në bazë të protokolleve përfundimtare në letër, por problemet teknike çuan në spekulime rreth transparencës së procesit dhe, në fund, në hetime zyrtare.

Ky raport ofron një numër rekomandimesh në mbështetje të përpjekjeve për përafrimin e mëtejshëm të zgjedhjeve në Maqedoninë e Veriut me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me reformën e kornizës ligjore, harmonizimin e të dhënave për regjistrin e zgjedhësve, rritjen e kapacitetit të institucioneve për mbikëqyrjen e financimit të fushatës, qasjen e papenguar në reklamat e paguara politike dhe me sigurinë kibernetike të procesit zgjedhor. ODIHR-i është i gatshëm t'i ndihmojë autoritetet që ta përmirësojnë procesin zgjedhor dhe t'i trajtojnë rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

II. HYRJE DHE MIRËNJOHJE

Në përgjigje të ftesës nga Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në përputhje me mandatin e saj, Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (ODIHR) krijoi më 19 qershor Misionin e Posaçëm për Vlerësimin e Zgjedhjeve (MPVZ) të udhëhequr nga Laima Andrikiënë.³ MPVZ-ja e ODIHR-it përbëhej nga një ekip kryesor prej nëntë ekspertësh ndërkombëtarë, të cilët ishin të vendosur në Shkup dhe vizituan Haraçinën, Gostivarin, Ilindenin, Kumanovën, Likovën, Tetovën dhe Vrapçishtin.

Procesi zgjedhor u vlerësua në aspektin e përputhshmërisë me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhjet demokratike, si dhe me legjislacionin kombëtar. MPVZ-ja nuk kreu një vëzhgim sistematik dhe gjithëpërfshirës të procedurave të votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve në ditën e zgjedhjeve, në përputhje me metodologjinë e ODIHR-it për misionet e vlerësimit të zgjedhjeve. Sidoqoftë, anëtarët e misionit vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh në ditën e zgjedhjeve.

MPVZ-ja e ODIHR-it dëshiron të falënderojë MPJ-në dhe Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ) për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre, si dhe t'u shprehë mirënjohje përfaqësuesve të institucioneve të tjera shtetërore, komisioneve zgjedhore, partive politike, kandidatëve, mediave, shoqërisë civile, komunitetit akademik, komunitetit diplomatik rezident dhe bashkëbiseduesve të tjerë për ndarjen e pikëpamjeve të tyre.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare fillimisht u caktuan të mbaheshin më 12 prill 2020. Vendimit për të shpallur zgjedhje të parakohshme i parapriu vendimi i Këshillit të Evropës në tetor të vitit 2019 për moshapjen e negociatave për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian (BE), i cili e nxiti qeverinë të jepte dorëheqjen. Më 3 janar të vitit 2020, kryeministri dha dorëheqjen dhe, në përputhje me Marrëveshjen e Përzhinës të vitit 2015, një qeveri kalimtare, duke përfshirë edhe ministra të opozitës, e mori detyrën 100 ditë para zgjedhjeve të planifikuara.⁴ Më 16 shkurt, kryetari i parlamentit e shpërndau parlamentin dhe shpalli mbajtjen e zgjedhjeve më 12 prill, rreth tetë muaj para skadimit të mandatit të Kuvendit.

Për shkak të përhapjes globale të KOVID-19, më 18 mars, Presidenti i vendit shpalli gjendjen e jashtëzakonshme 30-ditore, ndërsa më 21 mars zgjedhjet u pezulluan me një dekret qeveritar, i cili parashikonte që procesi zgjedhor të rifillonte nga dita e heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme.⁵ Gjendja e jashtëzakonshme, me të cilën qeverisë kalimtare iu dhanë kompetenca të jashtëzakonshme legjislative, u zgjat katër herë, duke përfshirë herën e fundit për vetëm tetë ditë me qëllim rivendosjen e datës së

³ MPVZ-ja e rifilloi procesin e vëzhgimit të zgjedhjeve të filluar më 1 mars nga Misioni i ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ), i udhëhequr nga Tana de Zulueta, i cili u pezullua në 17 mars pas futjes së kufizimeve për udhëtimet ndërkufitare në gjithë rajonin e OSBE-së për shkak të përhapjes globale të KOVID-19.

⁴ [Marrëveshja e Përzhinës](#) parashikoi krijimin e një qeverie kalimtare 100 ditë para zgjedhjeve parlamentare të vitit 2016. Kjo kërkesë u bë e përhershme pas ndryshimeve në Ligjin për Qeverinë.

⁵ Vendimi i fundit për vazhdimin e gjendjes së jashtëzakonshme, i datës 15 qershor, u mor dy ditë pasi skadoi vendimi i mëparshëm. Përkundër dekretit të qeverisë të datës 21 mars, aktivitetet parazgjedhore nuk rifilluan në periudhën ndërhyrëse.

zgjedhjeve.⁶ Një numër kundërshtimesh u parashtruan në Gjykatën Kushtetuese lidhur me legjitimitetin e vendimeve të Presidentit për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme pa miratimin e parlamentit dhe për kompetencat ligjore që i janë dhënë qeverisë (Shih *Kundërshtimet dhe Ankesat*).⁷ Data e zgjedhjeve të 15 korrikut u përcaktua pas negociatave të gjata mes partive politike, të përqendruara në nevojën e rikrijimit të një qeverie dhe parlamenti të rregullt, si dhe për marrjen e masave të sigurisë për mbajtjen e zgjedhjeve gjatë periudhës së pandemisë. Këto ishin zgjedhjet e pesta radhazi të parakohshme parlamentare që nga viti 2008 dhe shumë bashkëbisedues theksuan pasojat politike dhe ekonomike të kësaj paqëndrueshmërie.

Zgjedhjet e mëparshme parlamentare u mbajtën në dhjetor të vitit 2016, kur gjashtë parti dhe koalicionet fituan përfaqësim në Kuvend.⁸ Megjithatë koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) fitoi më shumë mandate deputetësh, qeveria e re u formua në prill të vitit 2017 nga koalicioni që udhëhiqej nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) dhe përfshinte partinë kryesisht të shqiptarëve etnikë, Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI).

Në përgjithësi, gratë nuk janë të përfaqësuara sa duhet në jetën publike.⁹ Masat në Kodin Zgjedhor për të promovuar kandidatet femra në listat e partive e rritën përfaqësimin e grave në parlamentin në largim, ku kishte 47 gra nga 120 deputetë gjithsej. Megjithatë, gratë janë më pak të pranishme në pushtetin ekzekutiv; vetëm 5 nga 24 ministra në qeverinë në largim ishin gra, dhe vetëm 6 nga 81 kryetarë komunash janë gra.

Ndërkohë që zgjedhjet u pezulluan, ndodhën zhvillime kyçe në proceset e anëtarësimit në BE dhe në NATO. Më 24 mars, Këshilli i Çështjeve të Përgjithshme të BE-së miratoi hapjen e negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut, kurse më 27 mars vendi u bë zyrtarisht anëtar i aleancës së NATO-s.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KORNIZA LIGJORE

Kuvendi është një organ me një dhomë dhe përbëhet nga 120 deri në 123 deputetë, të cilët zgjidhen në zgjedhje të drejtpërdrejta me mandat katërvjeçar sipas modelit të përfaqësimit proporcional duke përdorur lista të mbyllura. Mandatet u shpërndahen listave të kandidatëve sipas metodës së *D'Hondt*-it, në bazë të mesatares më të lartë. Njëzet deputetë zgjidhen nga secila nga gjashtë njësitë zgjedhore brenda vendit, dhe deri në tre deputetë zgjidhen nga njësia e vetme zgjedhore jashtë vendit. Numri i deputetëve të zgjedhur në njësinë zgjedhore jashtë vendit është i kushtëzuar nga një prag që lidhet me rezultatet e zgjedhjeve të mëparshme, por që nuk është i lidhur me pjesëmarrjen e votuesve, që më parë

⁶ Kushtetuta lejon shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në rast të ndonjë fatkeqësie të madhe natyrore ose epidemie. Më 8 korrik, Gjykata Kushtetuese refuzoi ta vlerësojë kushtetutshmërinë e vendimit presidencial për vazhdimin e gjendjes së jashtëzakonshme për qëllime zgjedhore, duke arsyetuar gjatë seancës se shqyrtimi i vonë i tij e bën vendimin të parëndësishëm, mund ta dëmtojë procesin zgjedhor dhe ta verë në dyshim ligjshmërinë e dekreteve të detyrueshme qeveritare të miratuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme; vendimi me shkrim citoi pengesat procedurale për refuzimin.

⁷ Gjykata Kushtetuese deklaroi se ata nuk mbanin regjistrë gjithëpërfshirës të të gjitha kërkesave të parashtruara në lidhje me zgjedhjet dhe nuk mund ta siguronin numrin e tyre të saktë.

⁸ Në zgjedhjet e vitit 2016, koalicioni i VMRO-DPMNE-së fitoi 51 deputetë, koalicioni i LSDM-së 49, BDI-ja 10, BESA 5, Aleanca për Shqiptarët (ASH) 3 dhe Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH) 2 deputetë.

⁹ Shih paragrafin 29 të [Vëzhgimeve përmbyllëse të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 2018](#), i cili vuri në dukje se "gratë mbeten të papërfaqësuara në mënyrë adekuate në Kuvend, në Kabinet dhe në këshillat komunale, në mesin e kryetarëve të komunave, në pozitat vendimmarrëse në shërbimin diplomatik dhe në gjyqësi." Paragrafi 21 vë në dukje gjithashtu "këmbënguljen në stereotipe diskriminuese gjinore në lidhje me rolet dhe përgjegjësitë e grave dhe burrave në familje, në sistemin arsimor dhe në shoqëri".

ishite kritikuar nga ODIHR-i dhe Komisioni i Venedikut për mosrespektimin e parimit universal të së drejtës së votës.¹⁰

Maqedonia e Veriut i ka ratifikuar instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale për të drejtat e njeriut që kanë të bëjnë me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.¹¹ Korniza ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare përfshin Kushtetutën e vitit 1991 (e ndryshuar për herë të fundit në vitin 2019), Kodin Zgjedhor të vitit 2006 (i ndryshuar për herë të fundit në shkurt të vitit 2020), Ligjin për Partitë Politike të vitit 2004, Ligjin për Financimin e Partive Politike të vitit 2004 (i ndryshuar në vitin 2018) dhe rregulloret e miratuara nga KSHZ-ja për plotësimin e ligjit.¹²

Zgjedhjet u zhvilluan në bazë të kornizës ligjore që u ndryshua thelbësisht në prag të shpalljes së zgjedhjeve, në kundërshtim me praktikat e mira ndërkombëtare.¹³ Ndryshimet e futura në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 trajtuan pjesërisht disa rekomandime të ODIHR-it për çështje si regjistrimi i zgjedhësve, transparenca e zgjidhjes së kontesteve zgjedhore, afatet për dorëzimin e raporteve për financimin e fushatës dhe mbikëqyrja e fushatës. Megjithatë, disa rekomandime të ODIHR-it mbeten të patrajuara, duke përfshirë ato mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, procedurat e rekrutimit dhe shkarkimit të anëtarëve të administratës zgjedhore, rregullat e financimit të fushatës, kontrollin efektiv të financimit të fushatës dhe sanksionimin.¹⁴

Shumica e bashkëbiseduesve të MPVZ-së, duke përfshirë edhe KSHZ-në, organet shtetërore dhe partitë politike, nënvizuan nevojën për një reformë gjithëpërfshirëse të legjislacionit zgjedhor. Mospërputhjet e vazhdueshme, zbrazëtitrat, dispozitat e skaduar dhe të pazbatueshme, dhe formulimet e paqarta në kornizën ligjore e dëmtojnë qartësinë ligjore dhe kërkojnë rishikim thelbësor të mëtejshëm. Rregulloret jokonsekuente përfshijnë normat për mirëmbajtjen dhe modifikimin e regjistrimit të zgjedhësve, afate të

¹⁰ Kandidati zgjidhet në njësinë zgjedhore jashtë vendit, nëse lista përkatëse merr të paktën numrin më të vogël të votave të fituara nga një deputet brenda vendit në zgjedhjet e mëparshme; për këto zgjedhje pragu është 6.534 vota. Kandidati i dytë dhe i tretë zgjidhet nëse lista e tyre fiton përkatësisht dy herë dhe tre herë më shumë vota. Në rast se asnjë listë në njësinë zgjedhore jashtë vendit nuk e fiton numrin e kërkuar të votave, nuk zgjidhet asnjë deputet. Procedura e regjistrimit dhe rezultati i tij u kontestuan në Gjykatën Administrative, në Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve dhe në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Paragrafi 20 i [Mendimit të përbashkët për Kodin Zgjedhor i ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut i vitit 2016](#) rekomandon që "të sigurohet një procedurë alternative në mënyrë që e drejta e votës për të gjithë votuesit me të drejtë vote jashtë vendit, siç parashikohet me Kodin Zgjedhor, të garantohet në përputhje me parimin e barazisë së votës".

¹¹ Vendi ka ratifikuar të gjitha instrumentet kryesore ndërkombëtare dhe rajonale të të drejtave të njeriut, Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike të vitit 1966 (KNDP), Konventën e Kombeve të Bashkuara (KB) për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave të vitit 1979 (CEDAW), Konventën e KB-së për të Drejtat e të Personave me Aftësi të Kufizuara të vitit 2006 (KDPK), Konventën Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor të vitit 1965 (KNEDR) dhe Konventën e KB-ve Kundër Korrupsionit të vitit 2003 (UNCAC). Vendi është anëtar i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore të vitit 1950 (KEDNJ) dhe i nënshtrohet juridiksionit të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Vendi gjithashtu merr pjesë në Komisionin Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venedikut) dhe në Grupin e Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO).

¹² Ligje të tjera që kanë të bëjnë me zgjedhjet janë Ligji për Mediat, i ndryshuar në vitin 2014, Ligji për Shërbimet Audio dhe Audiovizuale Mediatike, i ndryshuar në vitin 2020, Ligji për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave i vitit 2019, Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i vitit 2020 dhe Ligji për Procedurën Administrative i vitit 2019, dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal. Për zgjedhjet e vitit 2020, KSHZ-ja rregulloi, ndër të tjera, regjistrimin e kandidatëve, zhvillimin e fushatës, procedurat për përcaktimin e identitetit të votuesve, votimin e personave me aftësi të kufizuara, votimin e të burgosurve, si dhe votimin në shtëpi dhe votimin në institucionet e përkujdesjes, përcaktimin e fletëvotimeve të pavlefshme, vëzhgimin e zgjedhjeve dhe zgjidhjen e kontesteve në lidhje me zgjedhjet nga KSHZ-ja dhe KZK-të.

¹³ Shih paragrafin II.2.b. të [Kodit të praktikës së mirë për çështjet zgjedhore të vitit 2002](#) të Komisionit të Venedikut dhe paragrafin 5 të [Deklaratës Interpretuese mbi Stabilitetin e Ligjit Zgjedhor](#) të po këtij Komisioni.

¹⁴ Sipas paragrafit 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet".

paharmonizuara për regjistrimin e zgjedhësve dhe të kandidatëve, normat e zhvillimit të fushatës dhe afatet që lidhen me të, përcaktimin e çmimeve për reklamat politike dhe shpërndarjen e kuotave për reklamat politike mes pjesëmarrësve në fushatë, kompensimin për shpenzimet e fushatës, raportimin e kontributeve në natyrë për qëllime të fushatës, diapazonin e raportimit financiar, mbylljen e llogarive të fushatës, ndarjen e kompetencave për zgjidhjen e kontesteve midis organeve për menaxhimin e zgjedhjeve. Dispozitat e reja mbi gjurmët e gishtave gjatë identifikimit të votuesve duhet të rishikohen për t'u siguruar që procedurat kanë qëllim të ligjshëm dhe se i përfshijnë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.¹⁵ Dispozitat në lidhje me kompensimin nga buxheti të shpenzimeve të fushatës nuk janë më të vlefshme, pasi këto të drejta u anuluan dhe duhet të shfuqizohen.

Ndryshimet e shkurtit të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor u miratuan me procedurë të përshpejtuar, pa debat të përgjithshëm, në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it dhe me Rregulloren e Kuvendit.¹⁶ Propozimet e grupit ndërinstytucional të punës, që kishte për detyrë të propozonte ndryshime në Kodin Zgjedhor nuk u përfshinë.¹⁷ Miratimi i nxituar e pengoi zbatimin efektiv të ndryshimeve, pasi nuk u eliminuan disa mangësi të mëparshme rregullore dhe nuk u sigurua gjithnjë kapaciteti administrativ dhe infrastruktura.

Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për ta harmonizuar brendapërbrenda dhe me ligjet e tjera përkatëse, si dhe për ta sjellë në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet ndërkombëtare dhe praktikën e mira. Rishikimi duhet të bëhet mes një procedure publike, pas një procesi konsultimi gjerësisht gjithëpërfshirës dhe në kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të ardhshme për të garantuar qartësi ligjore.

Kodi Zgjedhor lejon devijim deri në pesë për qind nga numri mesatar i votuesve për njësi zgjedhore. Në katër njësi zgjedhore kishte pabarazi më të mëdha.¹⁸ Me ndryshimet që u bënë në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 u ndryshuan kufijtë e dy njësive zgjedhore, duke i zhvendosur dy komuna, atë të Dibrës dhe Mavrovë-Rostushës, nga njësia zgjedhore numër gjashtë në njësinë zgjedhore numër pesë.¹⁹

¹⁵ Sipas nenit 108-a (8), votuesit i fusin gjurmët e gishtave pasi të ketë përfunduar identifikimi i tyre. Ligji nuk përcakton qëllimin e mbledhjes së të dhënave të ndjeshme të votuesve dhe kushtet në të cilat duhet të ruhet integriteti i të dhënave. Hyrja në fuqi e nenit 108-a ishte e kushtëzuar nga aftësia e KSHZ-së për të zbatuar teknologjitë e reja dhe nuk vlente për këto zgjedhje.

¹⁶ Paragrafi 5.8 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) kërkon që legjislativi të “miratohet në fund të një procedure publike”. Shih, po ashtu, paragrafët 11-12 të [Mendimit të përbashkët për Kodin Zgjedhor të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut të vitit 2016](#). [Rregullorja](#) e Kuvendit përcakton procedurë të shkurtuar vetëm për propozim-ligjet që nuk janë të ndërlikuara dhe vëllimore; që kanë të bëjë me ndërprerjen e vlefshmërisë së ndonjë ligji; dispozitat e veçanta të ndonjë ligji; ose nëse nuk janë në pyetje harmonizime komplekse dhe vëllimore të ligjit me legjislativin e Bashkimit Evropian, ndërsa për propozim-ligjet me interes të gjerë publik, është përcaktuar mbajtja e debatit publik.

¹⁷ Grupi i punës u krijua në bazë të Marrëveshjes së Përzhinës dhe u riformua pas një marrëveshjeje më 20 korrik të vitit 2016 midis katër partive kryesore politike. Grupi i punës vazhdoi aktivitetet e tij në vitin 2018 dhe 2019 nën koordinimin e Ministrisë së Drejtësisë. Së paku nëntë institucione të interesit përgatitën dhe dorëzuan komente dhe propozuan ndryshime në Kodin Zgjedhor përpara shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2020, duke përfshirë kërkesat për dorëzimin e raporteve për financimin e fushatës dhe procedurat e revizionit dhe funksionet mbikëqyrëse të organeve të përfshira, masat kundër klientelizmit gjatë mbulimit të fushatës, rregulloret dhe mbikëqyrjen e fushatës, dhe mbrojtjen e të drejtave të votimit.

¹⁸ Sipas KSHZ-së, në shkurt të vitit 2020, teprica në njësinë zgjedhore 6 ishte 8.60 për qind, ndërsa në njësinë zgjedhore 2 ajo ishte 5.74 për qind. Përqindje më të vogla se kufiri ligjor u raportuan në njësinë zgjedhore 4 (6.36 për qind) dhe në njësinë zgjedhore 3 (7.64 për qind). Njësitë zgjedhore 1 dhe 5 ishin brenda kufirit ligjor të devijimit. Për ndryshimin e kufijve në njësinë zgjedhore 6 lloboi BDI-ja, partia më e madhe parlamentare e shqiptarëve etnikë, dhe kjo u konsiderua gjerësisht si një kompromis politik. Bashkëbiseduesit e MPVZ-së së ODIHR-it ishin të mendimit se ndryshimet në njësitë zgjedhore 3 dhe 4 nuk u miratuan pasi ato nuk kishin ndonjë interes politik strategjik.

¹⁹ Kodi Zgjedhor kërkon përcaktimin e kufijve të njësive zgjedhore në rast se devijimi nga numri mesatar i votuesve tejkalon pesë për qind, megjithatë nuk u bë asnjë vlerësim konkret i mospërputhjes e as nuk u përshkrua metodologjia e aplikuar për përcaktimin e kufijve të vitit 2020 nga ana e Kuvendit. Shih paragrafin 7.3 të Dokumentit të OSBE-së

Pavarësisht devijimit mbi kufirin ligjor në njësitë zgjedhore numër tre dhe katër, kufijtë e këtyre njësiteve zgjedhore mbetën të pandryshuara.

Për të siguruar barazinë e votës, legjislacioni duhet të parashikojë rishikimin periodik të kufijve të njësiteve zgjedhore nga një organ i pavarur. Kur ripërcaktohen kufijtë e njësiteve zgjedhore, kjo duhet të bëhet në kohë, në mënyrë transparente, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse, në bazë të një metodologjie të qartë dhe të qëndrueshme.

Pavarësisht interpretimit nga Gjykata Kushtetuese se kompetencat legjislative të qeverisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duhet të përshtaten me nevojat e veçanta, dekretet e detyrueshme qeveritare përfshinin një pjesë të madhe të jetës publike, duke përfshirë edhe procedurat zgjedhore, të cilat, në bazë të Kodit Zgjedhor, janë në kompetencë të institucioneve, duke i zëvendësuar vendimet e këtyre institucioneve.²⁰ Dekretet rregullonin rifillimin dhe zhvillimin e procesit zgjedhor, vlefshmërinë e procedurave të përfunduara më parë, regjistrimin e votuesve, zhvillimin e fushatës në media, si dhe përcaktuan standarde dhe procedura për respektimin e protokolleve shëndetësore, duke përfshirë edhe një ditë shtesë votimi për votuesit që rezultojnë pozitivë ndaj COVID-19 dhe të atyre që ishin në vetëizolim. Rregullorja qeveritare për ngjarjet në hapësira të mbyllura dhe të hapura u ndryshua disa herë dhe kishte mungesë konsekuente dhe konsolidimi, duke dëmtuar qartësinë ligjore dhe zbatimin.²¹ Në përgjithësi, miratimi i vazhdueshëm i ndryshimeve të dekretëve e zbehu kuptimin e përgjithshëm të thelbit dhe vlefshmërisë së tyre.²²

V. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet u administruan nga një strukturë me tre nivele, e udhëhequr nga KSHZ-ja dhe e mbështetur nga Sekretariati dhe 34 Zyra rajonale, 80 Komisione Zgjedhore Komunale (KZK) dhe 3.480 Këshilla Zgjedhore (KZ).

KSHZ-ja është autoriteti më i lartë zgjedhor me kompetenca rregullatore, monitoruese dhe mbikëqyrëse dhe është përgjegjëse për organizimin dhe mbikëqyrjen e zgjedhjeve dhe referendumeve. Ajo ka shtatë anëtarë të emëruar nga partitë politike parlamentare: katër nga partitë në pushtet, duke përfshirë edhe nënkryetarin dhe tre nga opozita, duke përfshirë edhe kryetarin. Tre nga anëtarët aktualë të KSHZ-së janë gra, duke përfshirë edhe nënkryetaren. Mandati i Komisionit, i parashikuar fillimisht për gjashtë muaj për administrimin e referendumit të vitit 2018, u zgjat dy herë; së pari në nëntor të vitit 2018 për deri në dy vjet dhe më pas, në bazë të një dekreti qeveritar të lëshuar më 21 mars të vitit 2020, deri në gjashtë muaj nga mbajtja e zgjedhjeve parlamentare të vitit 2020.

të Kopenhagës të vitit 1990; I.2.2 vii. të Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore dhe paragrafin 17 të Raportit Shpjegues; [Raporti i Komisionit të Venedikut për Ndarjen e Njësiteve Zgjedhore dhe Ndarjen e Mandateve i vitit 2017](#) (CDL-AD (2017) 034). Shih gjithashtu paragrafin 3.3 të [Përkushtimeve Ekzistuese për Zgjedhjet Demokratike në Vendet Pjesëmarrëse të OSBE-së](#).

²⁰ Qeveria i rishpërndau kuotat për reklamat e paguara politike në mediat transmetuese dhe e ndryshoi kompensimin nga buxheti për reklamimin e paguar politik, që fillimisht ishin brenda kompetencave të Agjencisë për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike (ASHAAM) dhe KSHZ-së, respektivisht.

²¹ Protokollat për tubimet në hapësira të mbyllura dhe të hapura u integruan në një vendim qeveritar për parandalimin e COVID-19 që u ndryshua 28 herë me masa të vlefshme për faza të ndryshme të pandemisë. Protokollin e fundit lidhur me zgjedhjet për ngjarjet në hapësira të mbyllura dhe të hapura u miratua gjashtë ditë pasi filloi fushata dhe u ndryshua dy herë gjatë fushatës. Vendimet për ndryshimet dhe tekstet e ndryshimeve u botuan veçmas, nganjëherë me diferencë prej disa ditësh.

²² Paragrafi 58 i [Listës kontrolluese të sundimit të ligjit të Komisionit të Venedikut të vitit 2017](#) thotë se "[...] ligji, kur është e mundur, duhet të shpallet përpara zbatimit dhe efektet e tij duhet të jenë të parashikueshme: ai gjithashtu duhet të formulohet me saktësi dhe qartësi të mjaftueshme për t'u mundësuar subjekteve juridike ta rregullojnë sjelljen e tyre në përputhje me të".

Për të siguruar stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës zgjedhore, mandati i anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet të përcaktohet qartë nga Kodi Zgjedhor. Kodi duhet gjithashtu të parashikojë një procedurë të qartë dhe transparente të nominimit dhe emërimit të anëtarëve të KSHZ-së.

Administrata zgjedhore i kreu detyrat e saj brenda afateve ligjore, pavarësisht ndërlikimeve të shkaktuara nga pezullimi i procesit zgjedhor dhe shqetësimeve të paraqitura publikisht nga KSHZ-ja gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në lidhje me kalendarin zgjedhor. Bashkëbiseduesit e MPVZ-së së ODIHR-it u shprehën në përgjithësi të kënaqur me efektivitetin e KSHZ-së, megjithëse disa e vunë në diskutim strukturën partiake të Komisionit. KSHZ-ja i miratoi vendimet në mënyrë kolegjiale, shpesh me debate thelbësore, në mbledhje që ishin të hapura për vëzhguesit dhe që transmetoheshin drejtpërdrejt në ueb-faqen e Agjencisë shtetërore të Lajmeve të Maqedonisë (MIA) dhe në faqen e Facebook-ut të KSHZ-së. Mbledhjet shpesh parapriheshin nga mbledhje joformale të mbyllura të KSHZ-së, në të cilat diskutoheshin propozim-vendimet. Në disa mbledhje u ofrua interpretim në gjuhën e shenjave, gjë që e rriti disponueshmërinë e informacionit për personat me dëgjim të dëmtuar. Shumica e mbledhjeve të KSHZ-së u njoftuan pak para se ato të mbaheshin, vendimet dhe procesverbalet u publikuan në ueb-faqen e KSHZ-së, përgjithësisht në kohë, por publikimi i procesverbaleve u ndërpre me mbledhjen e KSHZ-së të mbajtur më 9 korrik.²³

Me ndryshimet që u bënë në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 u rishpërndanë disa përgjegjësi kryesore midis komisioneve zgjedhore dhe organeve shtetërore, ndërsa KSHZ-së iu caktua një spektër i gjerë kompetencash të reja. Këto detyra të reja përfshijnë hetimin e shkeljeve të pretenduara dhe shqyrtimin e provave në mekanizmat e zgjidhjes së kontesteve, inicimin e procedurave për parregullsitë zgjedhore *ex officio* dhe përcaktimin e çmimeve për reklamat politike në mediat transmetuese, të shkruara dhe në internet (online). (Shih përkatësisht seksionet *Kundërshtimet dhe ankesat* dhe *Mediat*). KSHZ-ja e informoi ODIHR-in se i mungojnë udhëzimet ligjore dhe kapaciteti institucional për t'i kryer në mënyrë adekuate këto detyra dhe ishte e mendimit se organet e specializuara profesionale do të ishin më të përgatitura të merren me to.

Sekretariati i KSHZ-së vazhdon të ketë mungesë punonjësish, në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Për periudhën zgjedhore, KSHZ-ja përdor një praktikë të forcimit të burimeve të saj njerëzore përmes angazhimit të personelit shtesë të përkohshëm nga institucionet e tjera shtetërore. Kjo zgjidhje vazhdon të minojë efektivitetin e përgatitjeve dhe qëndrueshmërinë për t'iu përgjigjur sfidave të paparashikuara kur ato paraqiten. Për më tepër, sipas disa raportimeve të bëra tek MPVZ-ja, disa prej punonjësve të angazhuar ishin të lidhur politikisht.

Personeli thelbësor duhet të punësohet në Sekretariatit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në baza të përhershme. Kapaciteti i burimeve njerëzore të Sekretariatit duhet të përputhet me kompetencat që i janë dhënë Komisionit në bazë të Kodit Zgjedhor.

KZK-të e emëruara në vitin 2016 me një mandat pesë-vjeçar, janë përgjegjëse për administrimin e zgjedhjeve në komunat e tyre përkatëse. Ata përbëhen nga pesë nëpunës shtetërorë të zgjedhur rastësisht dhe nga zëvendësit e tyre. KZK-të janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit zgjedhor në secilën komunë, dhe detyrat e tyre përfshijnë regjistrimin e kandidatëve, emërimin dhe trajnimin e KZ-ve, nxjerrjen dhe shpalljen e rezultateve komunale, si dhe përgatitjet e tjera teknike nën drejtimin e KSHZ-së. Anëtarët e KZ-ve u zgjodhën në vitin 2017 me një mandat prej katër vjetësh. Secila nga partitë politike në pushtet dhe partitë në opozitë që fituan më shumë vota në zgjedhjet e fundit parlamentare, për çdo zgjedhje, emërojnë nga një anëtar të përkohshëm të KZ-ve dhe zëvendësit e tyre; tre anëtarët e mbetur të KZ-ve zgjidhen rastësisht nga baza e të dhënave të punonjësve shtetërorë.

²³ Shih [procesverbalet e publikuara të mbledhjeve të KSHZ-së](#).

Sipas Kodit Zgjedhor, përbërja e çdo organi për menaxhimin e zgjedhjeve duhet të respektojë kërkesat ligjore për përfaqësimin etnik dhe gjinor.²⁴ Pjesëtarët e çdo gjinie duhet të përbëjnë të paktën 30 për qind të të gjitha KZK-ve dhe KZ-ve. 45 për qind të anëtarëve të KZK-ve ishin gra dhe në 32 për qind të KZK-ve kryetaret ishin gra. Nuk pati të dhëna të disponueshme për ndarjen sipas gjinisë për përbërjen e KZ-ve. Përfaqësimi i drejtë i bashkësive etnike kërkohet për të gjitha KZK-të dhe KZ-të në komunat në të cilat të paktën 20 për qind e popullsisë u përkasin këtyre bashkësive.²⁵

Baza e të dhënave e punonjësve shtetërorë që mirëmbahet nga Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës (MSHIA) është e vjetruar dhe e ngadalësoi procesin e zëvendësimit të një numri të konsiderueshëm të anëtarëve të KZ-ve. Zëvendësimet lindën fillimisht si rrjedhojë e vendimit të qeverisë në mars për të tërhequr rreth 3.200 punonjës shëndetësorë në përgjigje të nevojave të KOVID-19, dhe më pas nga dorëheqja e një numri të ngjashëm shtesë të disa anëtarëve të KZK-ve dhe KZ-ve, të cilët dhanë përgjithësisht si arsye shqetësimet për shkak të KOVID-19 ose gjendjen shëndetësore. Megjithëse këto komplikime nuk duket se ndikuan në ditën e zgjedhjeve, ato e rritën në mënyrë të panevojshme ngarkesën e punës së punonjësve të KSHZ-së gjatë përgatitjeve të zgjedhjeve. Për më tepër, disa nga institucionet shtetërore të përfshira në procesin zgjedhor, si Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR), e informuan MPVZ-në se punonjësit e tyre janë të përfshirë në bazën e të dhënave dhe janë të detyruar të shërbejnë në KZK-të dhe KZ-të, gjë që potencialisht mund të ndikojë në kapacitetin e institucioneve.

Nëse do të mbahet si mjet për përzgjedhjen e anëtarëve të komisioneve zgjedhore, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës duhet ta përditësojë bazën e të dhënave të nëpunësve publikë, duke angazhuar institucionet përkatëse. Autoritetet mund ta konsiderojnë rishikimin e grupit të organeve shtetërore, nga të cilat angazhohen nëpunësit për të shërbyer në komisionet zgjedhore.

Numri i kufizuar i KZK-ve të vizituara nga MPVZ-ja e ODIHR-it demonstroi njohuri të përgjithshme solide të përgjegjësive të tyre, si dhe kuptim dhe përkushtim për zbatimin e masave për parandalimin e KOVID-19 në procesin zgjedhor.²⁶ Disa anëtarë të komisioneve zgjedhore komunale me të cilët u takua MPVZ-ja e ODIHR-it theksuan se KZK-të nuk janë organet e duhura për të shqyrtuar kundërshtimet në lidhje me shkeljet e të drejtës së votës gjatë votimit të hershëm dhe në ditën e zgjedhjeve, për shkak të funksionimit të tyre me ndërprerje dhe mungesës së mandatit në lidhje me saktësinë e listës së zgjedhësve. KZK-të me cilat u takua MPVZ-ja theksuan se ata i shpërndanë njoftimet për mbledhjet publike dhe i vendosën procesverbalet përkatëse në hyrje të ndërtesave të tyre përkatëse komunale.

Më 22 qershor, Komisioni për Sëmundje Infektive i Ministrisë së Shëndetësisë miratoi protokollin shëndetësor për zhvillimin e procedurave të ditës së zgjedhjeve. Zhvillimit të dokumentit i paraprinë konsultime me KSHZ-në dhe organizatat e shoqërisë civile, megjithëse, sipas disa bashkëbiseduesve, këto konsultime ishin të kufizuara dhe rekomandimet që dolën prej tyre nuk u integruan plotësisht. Në bazë të protokollit, KSHZ-ja gjithashtu miratoi një udhëzim për procedurat gjatë ditës së votimit, si dhe për regjistrimin dhe votimin e votuesve pozitivë ndaj KOVID-19 që janë në karantinë dhe atyre në vetë-izolim, dhe udhëzime mbrojtëse përkatëse për zyrtarët e zgjedhjeve. Megjithatë, një boshllëk në planin e trajnimit, i shkaktuar nga pezullimi i zgjedhjeve, krijoi sfida në sigurimin e trajnimit sistematik për procedurat që lidhen me aspektin shëndetësor për të gjithë anëtarët e komisioneve; KSHZ-ja u kujdes për organizimin e disa trajnimeve plotësuese.

²⁴ KSHZ-ja kreu një revizion të brendshëm të politikave të punës në fund të vitit 2019, i cili identifikoi masa për ta monitoruar dhe për ta avancuar integrimin dhe ndjeshmërinë gjinore në praktikën e saj administrative.

²⁵ Kjo kërkesë nuk ishte respektuar në disa komisione të vizituara nga vëzhguesit e ODIHR-it.

²⁶ MPVZ-ja e ODIHR-it i vizitoi KZK-të në Gostivar, Ilinden, Kumanovë, Shkup Qendër, Tetovë dhe Vrapçisht, para zgjedhjeve, vizitoi KZK-në në Aerodrom më 13 korrik për të vëzhguar dorëzimin e fletëvotimeve për personat me KOVID-19 dhe u kthye në KZK-në në Shkup Qendër pas zgjedhjeve.

KSHZ-ja rishikoi hapësirat e vendotimeve për të mundësuar kërkesat për distancë fizike, të parashikuara nga protokollat, megjithëse pranoi se në shumë raste respektimi i tyre nuk ishte i mundur për shkak të mungesës së hapësirave të përshtatshme në dispozicion. KSHZ-ja gjithashtu formoi 67 Këshilla të posaçme Zgjedhore për të zhvilluar votimin e hershëm më 13 korrik për votuesit që ishin pozitivë ndaj COVID-19 dhe për ata që ishin në vetë-izolim. KSHZ-ja u përball me sfida të konsiderueshme në formimin e KZ-ve të veçanta, përbërja e të cilave përfshinte tre punonjës shëndetësorë dhe dy përfaqësues të partive politike. Nga 300 punonjës shëndetësorë të zgjedhur fillimisht për të punuar në këto këshilla, mbi një e treta kërkuan të largohen.

Ajo çka është pozitive është se KSHZ-ja zhvilloi një fushatë gjithëpërfshirëse për edukimin e votuesve, e cila informoi mbi rregullat e përshtatura në aspektin shëndetor për zbatimin e procedurave në ditën e zgjedhjeve, dhe që u realizua në disa gjuhë, si në mediat tradicionale, ashtu edhe në ato online.²⁷ Ajo gjithashtu hapi një linjë telefonike për qytetarët për të kërkuar informacion ose për të lënë komente mbi zhvillimin e zgjedhjeve, duke përfshirë një linjë telefonike me video për qytetarët me dëgjim të dëmtuar.

VI. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Sipas Kushtetutës, qytetarët që janë 18 vjet ose më shumë në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtën e votës, por personat që me vendim gjykate privohen nga zotësia juridike për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale janë të privuar nga e drejta e votës, në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare dhe rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it.²⁸

Korniza ligjore duhet të harmonizohet me standardet ndërkombëtare, duke hequr çdo kufizim mbi të drejtat zgjedhore për shkak të aftësisë së kufizuar intelektuale ose psiko-sociale.

Regjistrimi i zgjedhësve rregullohet me Kushtetutë, me Kodin Zgjedhor dhe me disa dispozita të përkohshme, por nuk ka qartësi për rregulloret e hollësishme dhe të përhershme. Dy rregullore që përcaktojnë metodologjitë për mirëmbajtjen, përditësimin dhe qasjen në listën e zgjedhësve u miratuan në vitin 2016. Aktualisht njëra nga metodologjitë nuk zbatohet më, kurse tjetra, megjithëse zbatohet, shkakton mendime kontradiktore në lidhje me vlefshmërinë e saj ligjore.²⁹ Megjithëse ndryshimet e Kodit Zgjedhor të bëra në shkurt të vitit 2020 parashikuan Regjistrin Qendror të Popullsisë, si një burim të ri, nga i cili do t'i sigurohen KSHZ-së të dhënat për regjistrimin e zgjedhësve, ai nuk mundi të përdoret për këto zgjedhje, sepse ende nuk është i plotësuar me fotografi dhe adresa.

Për të siguruar një kornizë rregullatore gjithëpërfshirëse, Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet për të qartësuar dhe konsoliduar udhëzimet të hollësishme dhe të përhershme për procedurat e regjistrimit të zgjedhësve. Kërkesat në Kod duhet të përkrijnë me funksionalitetin e Regjistrin Qendror të Popullsisë.

KSHZ-ja ishte përgjegjëse për përpilimin e regjistrin të zgjedhësve në bazë të përditësimeve pasive dhe të rregullta të siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra për Udhëheqje me Librat e Gjendjes

²⁷ Po ashtu edhe në gjuhën maqedonase, shqipe, rome dhe serbe.

²⁸ Sipas KSHZ-së, nga ky kufizim janë ndikuar rreth 880 qytetarë. Neni 12 dhe 29 i [KDKPAK-së i vitit 2006](#) paragrafi 9.4 i [Komunikatës Nr. 4/2011 të Komitetit të KDKPAK-së i vitit 2013](#) parashikon që “përjashtimi i të drejtës për të votuar në bazë të paafhtësisë së perceptuar ose aktuale psiko-sociale ose intelektuale, duke përfshirë kufizimin në bazë të një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar”.

²⁹ Rregulloret përshkruajnë, në mënyrë përkatëse, një metodologji për mbajtjen dhe azhurnimin e listës së votuesve në bazë të inspektimeve dhe analizave statistikore, kontrolleve të kryqëzuara të bazave të të dhënave dhe shënimeve të ndryshme, inspektimeve të pakufizuara në terren dhe metodave të tjera të njohura në mënyrë adekuate të inspektimit dhe një metodologji për qasje të plotë, duke bërë ndryshime dhe fshirjen e të dhënave në listën e votuesve, si dhe procedurë për zbatimin e inspektimit në terren për azhurnimin e listës së votuesve.

Civile dhe gjykatat. Organizimi i votimit jashtë vendit bazohet në regjistrimin aktiv që kërkon një prag të barabartë me votat e nevojshme për të fituar një mandat në zgjedhjet e fundit. Procesi i regjistrimit jashtë vendit përfundoi më 17 mars, para pezullimit të zgjedhjeve dhe pragu i vendosur për këto zgjedhje në 6.534 votues të regjistruar, nuk u arrit.

Më 1 korrik, lista e votuesve u mbyll dhe ajo përfshinte 1.814.263 qytetarë, nga të cilët 83.054 ishin paraqitur se banojnë përkohësisht jashtë vendit dhe u regjistruan në një listë të veçantë që u ofrohet të gjitha KZ-ve. Përveç kësaj, KSHZ-ja regjistroi 10.882 kërkesa për votim të hershëm më 14 korrik në shtëpi, në institucione të kujdesit jashtë familjes dhe në burgje, dhe për 759 votues që ishin pozitivë ndaj KOVID-19 ose ishin në vetë-izolim për votimin e hershëm më 13 korrik.³⁰

Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, MPB-ja i siguroi KSHZ-së një listë të votuesve me letërnjoftime me afat të skaduar midis shpalljes së zgjedhjeve dhe ditës së zgjedhjeve, duke rritur përfshirjen e regjistrit të votuesve.³¹ Më 16 qershor, MPB-ja ia dha KSHZ-së listën e dytë të prodhuar pas këqyrjes publike, ku ishin përfshirë votuesit që kishin kërkuar dhe që kishin marrë letërnjoftimet e tyre të reja; vetëm lista e dytë u mor parasysht nga Komisioni. Kështu, qytetarët me letërnjoftime të skaduar që nuk i morën letërnjoftimet e reja para 16 qershorit u privuan nga e drejta e votës. Në bazë të ndryshimeve të bëra në shkurt të vitit 2020, për të marrë fletëvotim, të gjithë votuesit duhej të paraqisnin një letërnjoftim ose pasaportë të vlefshme.³²

Për ta lehtësuar ushtrimin e të drejtës së votës, mund të konsiderohen masa shitesë për t'u mundësuar votimin votuesve që votojnë për herë të parë që nuk kanë letërnjoftim, qytetarëve që u kanë skaduar letërnjoftimet pak para shpalljes së zgjedhjeve dhe qytetarëve që nuk i kanë marrë letërnjoftimet e reja para se të përditësohet lista e votuesve nga KSHZ-ja.

Para pezullimit të procesit zgjedhor, këqyrja publike e listës së votuesve kishte përfunduar dhe kopjet më pas iu ishin dorëzuar të gjitha partive politike. Megjithatë kalendari i ri zgjedhor lejoi azhurnimin sa i përket personave të vdekur dhe qytetarëve që kanë mbushur 18 vjeç, nuk u vendos ndonjë periudhë e re e veçantë e këqyrjes publike. Mekanizmi i azhurnimit të vazhdueshëm mbeti i disponueshëm përmes një motori të bazuar në internet që mundëson pyetje sipas numrit amë të identifikimit, mbiemrit dhe adresës.

Qytetarët dhe partitë politike mund të kërkojnë ndryshime në regjistrin e votuesve (p.sh. shtimin, heqjen ose ndryshimin e çfarëdo të dhëne) që prek qytetarët e tjerë, por shabllonet e KSHZ-së që përdoren për këqyrje publike i kufizojnë ndryshimet e tilla për rastet e vdekjes, humbjen e shtetësisë dhe privimin nga e drejta ligjore për të votuar, në kundërshtim me dispozitat e Kodit Zgjedhor.³³ Asnjë njoftim individual nuk u dërgohet qytetarëve që u janë ndryshuar të dhënat.

Shumë bashkëbisedues të MPVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësime në lidhje me saktësinë e listës së votuesve, përgjithësisht duke theksuar se numri i votuesve të regjistruar e tejkalon numrin e qytetarëve me vendbanim të përhershëm, duke e rritur kështu abstenimin. Çështjet strukturore shumëvjeçare, siç janë identifikuar në raportet e mëparshme të ODIHR-it, mbeten të patrajtuara. Adresat menaxhohen nga

³⁰ Sipas statistikave zyrtare, 989 persona u testuan si pozitivë ndaj koronavirusit pas 8 korrikut, që ishte afati i fundit për votimin e hershëm, dhe për këtë arsye nuk kishin mundësi të votojnë.

³¹ Megjithatë, dispozita e re nuk i mori parasysht qytetarët, letërnjoftimet e të cilëve skaduan pak para shpalljes së zgjedhjeve.

³² Pasaportat e skaduar ishin të pranueshme nëse vlefshmëria e tyre kishte mbaruar gjatë periudhës së gjendjes së jashtëzakonshme. Votuesit që votojnë për herë të parë, të cilët nuk i kanë marrë ende letërnjoftimet e tyre, nuk lejohen të votojnë pavarësisht se gjenden në listën e votuesve.

³³ Vetëm një kërkesë u paraqit nga një parti politike. Sipas rregullores përkatëse të KSHZ-së, kërkesat e bëra nga partitë politike mund të kufizohen në lloje të caktuara të korrigjimeve të të dhënave.

komunat së bashku me Regjistrin Qendror, por nuk ekziston ndonjë standardizim.³⁴ Të dhënat që i dërgohen KSHZ-së nga institucione të ndryshme dërgohen në formate të ndryshme, gjë që pengon ndërveprimin. Mospërputhjet burojnë gjithashtu nga fakti që spitalet nuk ofrojnë përditësime sistematike për të vdekurit.

Regjistri i votuesve u ndikua më tej edhe nga kapaciteti i kufizuar i TI-së i KSHZ-së dhe kohët e fundit nuk u krye asnjë kontroll gjithëpërfshirës në mënyrë sistematike i cilësisë së regjistrit të votuesve.³⁵ Sistemi i Menaxhimit të Informatave të Votuesve, i cili do t'i mundësonte KSHZ-së të merrte përsipër detyrat që tani kryhen nga Enti Shtetëror i Statistikave (EShR) dhe që do ta rriste ndjenjën e pronësisë të KSHZ-së mbi aspektet e TI-së, është ende duke u zhvilluar.

Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet harmonizimit të të dhënave që ofrohen për regjistrin e votuesve, përkatësisht ndërveprimin të të dhënave të marra dhe standardizimit të sistemit të adresave. Duhet të kryhen auditime cilësore të regjistrit dhe ato duhet të bëhen vazhdimisht publike.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Qytetarët që kanë mbushur 18 vjeç dhe që kanë të drejtë vote, kanë të drejtë të kandidojnë, duke përfshirë ata, të cilëve u është revokuar e drejta e votimit për shkak të aftësive të kufizuara intelektuale ose psiko-sociale, që është në kundërshtim me detyrimet ndërkombëtare dhe rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Përveç kësaj, korniza ligjore ua heq të drejtën e kandidimit atyre që aktualisht vuajnë një dënim me burg prej më shumë se gjashtë muajsh.³⁶

Kufizimet në të drejtën për të kandiduar duhet të rishikohen për t'u siguruar që skualifikimi për shkak të dënimit të jetë proporcional me peshën e veprës penale.

Kandidatët mund të emëroheshin nga partitë e regjistruara politike dhe koalicionet, si dhe nga grupe votuesish. Kandidatët e emëruar nga votuesit duhet të mbledhin së paku 1.000 nënshkrime mbështetëse nga votuesit që banojnë në njësinë përkatëse zgjedhore. Për herë të parë, duke zbatuar një rekomandim të mëparshëm të ODIHR-it, nënshkrimet mbështetëse të votuesve mund të mblidheshin në zyrat e noterëve, si dhe përpara punonjësve të KSHZ-së, në zyrat kompetente rajonale të KSHZ-së.³⁷ Megjithatë Kodi Zgjedhor nuk specifikon një listë të dokumenteve të nevojshme për emërimin e kandidatëve, KSHZ-ja lëshoi një udhëzim, ku shënohej lista e dokumenteve të nevojshme për kandidatët dhe ku përshkruhej procedura e hollësishme e verifikimit. Për këto zgjedhje, KSHZ-ja lëshoi edhe një aplikacion të ri online për paraqitjen e listave të kandidatëve.

³⁴ Një grup pune nën patronazhin e Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve zhvilloi një propozim-ligj që i mundëson Kadastrës të menaxhojë sistemin e adresave, si dhe u realizua një projekt pilot, por ky projekt nuk është aprovuar ende.

³⁵ Për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm teknik të KSHZ-së, Enti Shtetëror i Statistikave (EShR) është kryesisht i përfshirë në menaxhimin e të dhënave të regjistrimit të votuesve.

³⁶ Paragrafi 24 i [Dokumentit të OSBE-së të Kopenhagës i vitit 1990](#) parashikon pjesërisht se "çdo kufizim i të drejtave dhe lirive në një shoqëri demokratike, duhet të ketë lidhje me një nga qëllimet e ligjit në fuqi dhe të jetë në përpjesëtim të rreptë me qëllimin e ligjit".

³⁷ Pagesa e tarifave të noterit është përgjegjësi e grupeve të votuesve që i emërojnë kandidatët. Të paktën 1.000 votues jashtë vendit kërkohet të nënshkruajnë për kandidatët e propozuar përpara zyrtarëve në zyrat diplomatike ose konsullore.

Regjistrimi i kandidatëve u bë nga 12 deri më 20 mars, para pezullimit të procesit zgjedhor.³⁸ Në fund të periudhës së regjistrimit, asnjë grup votuesish nuk arriti të emërojë një listë kandidatësh, pasi asnjë grup nuk arriti të mbledhë numrin e kërkuar të nënshkrimeve.³⁹ KSHZ-ja regjistroi 12 parti politike dhe 3 koalicione, të cilët paraqitën gjithsej 1.598 kandidatë në 78 lista.⁴⁰ Për t'u vlerësuar është fakti që KSHZ-ja i publikoi të gjitha listat e kandidatëve në ueb-faqen e saj me një mjet interaktiv që shfaqte përkatësinë partiake të kandidatëve, gjininë, njësinë zgjedhore dhe komunën e tyre.

Në secilën listë, të paktën një kandidat i secilës gjini duhet të vendoset në çdo vend të tretë në listë, me një kandidat shtesë të gjinisë më pak të përfaqësuar në çdo dhjetë vende. Të gjitha listat e paraqitura e plotësuan kuotën e kërkuar prej 40 për qind, e disa e tejkaluan këtë prag. Gjithsej, 675 kandidatë të regjistruar (42 për qind e totalit) ishin gra, dhe gratë ishin në krye të 19 listave nga 78 lista gjithsej. Numri më i madh i listave të udhëhequra nga gratë - katër nga gjashtë lista - u regjistrua nga "Votë për Maqedoninë". Në listat e LSDM-së në çdo njësi zgjedhore, dy kandidatët e parë ishin një grua dhe një burrë, por gruaja u vendos në vendin e parë vetëm në një rast. Listat e VMRO-DPMNE-së udhëhiqeshin nga gratë në dy njësi zgjedhore.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet e caktuara fillimisht për 12 prill u pezulluan para se të fillonte periudha zyrtare e fushatës. Pas rifillimit të procesit zgjedhor, fushata u hap më 24 qershor dhe përfundoi në mesnatën e 12 korrikut, para ditës së parë të votimit të hershëm.

Kodi Zgjedhor e ndalon zhvillimin e fushatës në periudhën nga data e afatit të regjistrimit të kandidatëve (20 marsi) deri në datën kur fillon fushata zyrtare. Partitë politike zhvilluan disa aktivitete fushate para moratoriumit. LSDM-ja e mbajti kongresin e partisë më 9 mars, ndërsa VMRO-DPMNE-ja organizoi ngjarje më 11 mars për të prezantuar kandidatët dhe partnerët e saj të koalicionit. Përgatitjet për fushatën u kufizuan në mënyrë të konsiderueshme përpara pezullimit të zgjedhjeve në 21 mars. Më 10 mars, qeveria vendosi të ndalojë tubimet publike dhe ngjarjet me më shumë se 1.000 pjesëmarrës, si në hapësira të hapura, ashtu edhe në ato të mbyllura. Pas një takimi të kryetarëve të partive më 12 mars, partitë ranë dakord të mos zhvillojnë tubime për fushatë.

Pas rifillimit të procesit zgjedhor, në MPVZ-në e ODIHR-it u paraqitën disa pretendime se figura të larta politike po angazhoheshin në aktivitete të hershme të fushatës zgjedhore para 24 qershorit.⁴¹ Në disa raste, këto pretendime dukeshin të justifikuar, megjithëse situata ishte e paqartë, duke pasur parasysh që procesi zgjedhor u pezullua gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Rregullat për fushatën e hershme çojnë në situatën anormale, ku kandidatët e mundshëm dhe partitë e tyre zhvillojnë veprimtari politike deri në regjistrimin e tyre zyrtar dhe më pas janë të detyruar ta ndërpresin fushatën deri në fillimin e periudhës zyrtare të fushatës, ndërsa të tjerët që nuk janë të përfshirë drejtpërdrejt në zgjedhje lejohen t'i vazhdojnë aktivitetet e tyre gjatë gjithë kohës.

³⁸ Të gjitha 78 listat e parashtruara nga partitë politike u pranuan.

³⁹ Gjashtë kandidatë të pavarur nuk patën sukses të regjistrohen përmes mbledhjes së nënshkrimeve. Numri maksimal i nënshkrimeve të mbledhura ishte 255 në njësinë zgjedhore numër 4, ndërsa numri i përgjithshëm i nënshkrimeve të mbledhura nga të gjithë kandidatët individualë në gjithë vendin ishte 536. Dy kandidatë nuk arritën të mbledhin asnjë nënshkrim.

⁴⁰ Koalicionet përfshijnë: koalicionin me 23 parti të udhëhequr nga LSDM-ja me BESËN dhe një numër partish më të vogla, koalicionin me 16 parti të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja dhe koalicionin e dy partive etnike-shqiptare - Aleanca për Shqiptarët (ASH) me Alternativën.

⁴¹ KSHZ-ja i hodhi poshtë 42 kundërshtime në lidhje me zhvillimin e hershëm të fushatës si të pabaza (Shih *Kundërshtimet dhe Ankesat*).

Duhet konsideruar mundësia e përshtatjes së periudhës zyrtare të fushatës me periudhën kohore për regjistrimin e garuesve, për t'u siguruar se rregullat e fushatës vlejné në mënyrë konsekuente për të gjithë. Aktivitetet e rregullta politike para periudhës zyrtare të fushatës nuk duhet të ndalohen dhe duhet të rregullohen.

Një seri dekretesh dhe vendimesh qeveritare gjatë dhe pas gjendjes së jashtëzakonshme përcaktuan masat e sigurisë që duhen zbatuar në takimet publike, duke përfshirë përdorimin e dezinfektuesit të duarve, distancimin fizik dhe veshjen e maskave. Pandemia e KOVID-19 e ndryshoi ndjeshëm stilin e fushatës, pasi partitë miratuan masa shtesë, në pjesën më të madhe duke iu shmangur tubimeve tradicionale në favor të ngjarjeve të vogla, si dhe vizitave të kufizuara derë-më-derë dhe aktiviteteve të tjera për t'u takuar me votuesit. Përkundër rrethanave, partitë zhvilluan fushatë aktive dhe qenë në gjendje t'i përcillnin mesazhet e tyre. Fushata u zhvillua në një ambient të qetë dhe, pavarësisht nga rastet e izoluara të vandalizimit të posterëve të fushatës, liria e shprehjes u respektua. Garuesit u mbështetën në masë të madhe në rrjetet sociale, duke postuar video të takimeve lokale, në të cilat folën kandidatët dhe kryetarët e partive. Reklama të shumta lidhur me fushatën u transmetuan në mediat transmetuese dhe në rrjetet sociale, e po ashtu edhe bilbordet ishin mjaft të dukshme.

Çështjet kryesore të fushatës përfshinin ekonominë, reformën gjyqësore, mirëqenien sociale dhe kujdesin shëndetësor. LSDM-ja theksoi arritjet e saj në përparimin e bërë t'u anëtarësuar në NATO dhe BE. Duke iu përgjigjur pretendimeve të kundërshtarëve se kishte "shitur" interesin kombëtar, LSDM-ja pohoi se, duke nënshkruar Marrëveshjen e Miqësisë me Bullgarinë në vitin 2017 dhe Marrëveshjen e Prespës me Greqinë në vitin 2018, qeveria kishte mbrojtur identitetin kombëtar dhe gjuhën.⁴² Fushata u karakterizua nga një retorikë negative, në dëm të një debati thelbësor. Reklamat e VMRO-DPMNE-së përfshinin sulme personale ndaj kryetarit të LSDM-së. Nga ana e saj, LSDM-ja paralajmëroi kthimin e "regjimit" të ish-kryeministrit të VMRO-DPMNE-së, i dënuar dhe aktualisht i arratisur. Shpërndarja e një sërë regjistrimesh të fshehta të liderëve politikë në biseda mesa duket komprometuese kontribuuan edhe më shumë në këto tone negative.

Në një zhvillim para zgjedhjeve të vitit 2020, LSDM-ja hyri në koalicion parazgjedhor me BESËN; kjo ishte hera e parë që një nga dy partitë më të mëdha ka bërë marrëveshje parazgjedhore me një parti etnike shqiptare. Propozimi i BDI-së për kandidat shqiptar etnik për kryeministër shkaktoi debate të ashpra. LSDM-ja e kritikoi ashpër ish-partnerin e saj të koalicionit, BDI-në, duke e lidhur atë me ish-kryeministrin e VMRO-DPMNE-së dhe duke pretenduar se partia duhej të kalonte në opozitë dhe të reformonte radhët e saj. Retorika e shtuar u reflektua në një rritje të incidencës së gjuhës së urrejtjes me bazë etnike në mediat sociale, duke përfshirë edhe kundër pakicave shqiptare dhe rome.

Më 18 qershor, KSHZ-ja organizoi nënshkrimin e një kodi për zgjedhje të drejta dhe demokratike nga garuesit në zgjedhje. Më 29 qershor, Kryetari i KSHZ-së dhe Ministri i Punëve të Brendshme së bashku u bënë thirrje pjesëmarrësve në zgjedhje që ta respektojnë ligjin, duke paralajmëruar sanksione për presion, detyrim ose blerje të votuesve. Kryetari i shtetit dhe Kryeministri bënë deklaratat publike me argumente të ngjashme. MPVZ-ja e ODIHR-it vërejti raste të izoluara ministrash nga parti të ndryshme që i përziën funksionet e tyre shtetërore me aktivitetet politike, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.

Pati pretendime nga partitë e opozitës për përpjekje të bëra për shfrytëzimin për qëllime politike të programeve të ndihmave sociale dhe shpërndarjes së ndihmave të lidhura me pandeminë e KOVID-19 dhe pasojat ekonomike të saj. Ato përfshinin një program për shpërndarjen e ndihmës për njerëzit në nevojë përmes kartave të kreditit për blerjen e produkteve kombëtare. Kishte pretendime të mëtejshme

⁴² Pas Marrëveshjes së Prespës dhe referendumit konsultativ në shtator të vitit 2018, Kuvendi i miratoi ndryshimet kushtetuese në janar të vitit 2019 për ta ndryshuar emrin e vendit. Marrëveshja i dha fund mosmarrëveshjes shumëvjeçare me Greqinë mbi emrin e vendit dhe hapi rrugën drejt integritimit në NATO dhe BE.

se shpërndarja e ndihmave gjatë gjendjes së jashtëzakonshme duke se kishte lidhje me partitë politike. Asnjë provë bindëse për keqpërdorimet e tilla nuk iu paraqit MPVZ-së së ODIHR-it.

Partitë politike i raportuan gjithashtu MPVZ-së së ODIHR-it për disa raste presioni ndaj zyrtarëve publikë, veçanërisht në perëndim të vendit, duke përfshirë edhe përpjekjet për instrumentalizimin e policisë.⁴³ Ashtu si në zgjedhjet e mëparshme, MSHIA-ja krijoi një mjet *online*, përmes të cilit punonjësit publikë mund të denonconin raste të presionit mbi ta. U parashtruan vetëm dy denoncime, përkundër një numri pretendimesh për presion të raportuara nga mediat.⁴⁴

Në ditët e fundit para zgjedhjeve kishte disa pretendime për blerje votash anembanë vendit, duke përfshirë njerëz të rrezikuar në aspektin social, të cilët u përkisnin më shpesh komuniteteve rome, por jo vetëm. MPVZ-ja e ODIHR-it u informua se prokurorët në disa raste kishin nisur hetimet. Në ditët para zgjedhjeve kishte prova për përçarje brenda MPB-së. Ato reflektonin marrëveshjen për qeverinë kalimtare, sipas të cilës ministri i brendshëm u emërua nga partia opozitare e VMRO-DPMNE-së, kurse një zëvendësministër plotësues u emërua nga LSDM-ja, përveç zëvendësministrit të zakonshëm nga BDI-ja. Në ditët para zgjedhjeve, ministri dhe zëvendësministri plotësues morën qëndrime të kundërta në lidhje me pretendimet për blerje votash. Disa parti e informuan MPVZ-në e ODIHR-it se këto përçarje vazhduan edhe në ditën e zgjedhjeve, pasi partitë u përpoqën të angazhonin policinë në emër të tyre përmes ministrit ose zëvendësministrave të tyre përkatës. Duke pasur parasysh rolin vendimtar të policisë në sigurimin e një ambienti të sigurt për zgjedhje, politizimi i tillë i policisë është veçanërisht shqetësues.

Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme nga autoritetet për t'iu kundërvënë menjëherë çdo forme presioni mbi punonjësit e sektorit publik, duke përfshirë edhe policinë. Funkionarët publikë duhet të informohen sistematikisht në lidhje me mekanizmat në fuqi për të raportuar çdo rast presioni për hetim dhe të sigurohen se për këtë nuk do të kenë pasoja negative; këta mekanizma mund të kontrollohen nga një organ i pavarur.

Një rol më i madh i grave politikane ishte i dukshëm në ngjarjet e fushatës dhe në posterët në bilborde; megjithatë, gratë ishin më pak të përfaqësuara në mbulimin mediatik të fushatës. Gratë përbënin 42 për qind të kandidatëve të regjistruar, mirëpo monitorimi i MPVZ-së së ODIHR-it tregoi se mbulimi mediatik i grave politikane ndryshonte midis vetëm 4 dhe 14 për qind të mbulimit të kandidatëve. Kandidatet gra të cilat u takuan nga MPVZ-ja e ODIHR-it përshkruan mungesën e mbështetjes për gratë e mundshme lidere në strukturat e brendshme partiake.

Maqedonia e Veriut është një vend etnikisht i larmishëm.⁴⁵ Partitë tradicionalisht kanë garuar për vota kryesisht brenda bashkësive të tyre etnike, ndërsa koalicionet në pushtet janë formuar përtej ndarjes etnike, duke i përfshirë partitë etnike shqiptare. Megjithatë, që nga zgjedhjet parlamentare të vitit 2016, LSDM-ja është përpjekur aktivisht të fitojë mbështetje nga votuesit shqiptarë etnikë. Përveç partive që kryesisht i përfaqësojnë shqiptarët etnikë, disa parti i përfaqësojnë bashkësitë më të vogla etnike, shumica e të cilave janë në aleancë ose me koalicionin e LSDM-së ose me atë të VMRO-DPMNE-së. Përfaqësuesit e këtyre partive morën pjesë aktive në fushatë, veçanërisht në vendet ku janë të përqendruara bashkësitë e tyre. Në zgjedhjet e vitit 2020, kandidatët nga komunitetet rome gjithashtu kandiduan në listat e LSDM-së dhe të VMRO-DPMNE-së si anëtarë të këtyre partive, e jo si anëtarë të partive të pakicave. Një kandidate e tillë i tha MPVZ-së së ODIHR-it se ajo besonte se kështu do të

⁴³ Për shembull, MPVZ-ja e ODIHR-it foli me një polic, i cili e përshkroi presionin, të cilit, ai tha se i ishte nënshtruar nga eprorët e tij për të mbështetur BDI-në. Ai tha se edhe policë të tjerë kishin përjetuar presion të ngjashëm.

⁴⁴ Një rast u konsiderua se nuk kishte të bënte me zgjedhjet. Një raport i dytë iu përcoll Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK).

⁴⁵ Sipas regjistrimit të fundit të popullsisë të vitit 2002, 64.2 për qind e popullsisë u deklaruan si maqedonas etnikë, 25.2 për qind si shqiptarë etnikë, 3.8 për qind si turq etnikë, 2.7 për qind si romë etnikë, 1.8 për qind si serbë etnikë, 0.8 për qind si boshnjakë etnikë, dhe 0.5 për qind si vllleh etnikë.

kishte më shumë ndikim brenda koalicionit. Partia Popullore e Romëve, e krijuar para do kohësh, garoi e pavarur.

Në fushatë u bënë disa përpjekje për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara, por ato ishin të kufizuara në një qasje bamirësie, në vend që të promovonin koncepte të tilla si dizajnin universal dhe fuqizimin socio-ekonomik. Kur e nisi fushatën e LSDM-së në një konventë partiake më 9 mars, kryetari i partisë premtoi se hyrja në ndërtesat publike për personat me aftësi të kufizuara fizike, përmes platformave hyrëse, do të ishte e detyrueshme deri në vitin 2024 dhe se shtesa financiare për personat me aftësi të kufizuara do të rritet me 15 për qind. Ajo çka ishte pozitive ishte se videot e ngjarjeve të fushatës në mediat sociale ndonjëherë përfshinin interpretim në gjuhën e shenjave. Programi i LSDM-së u përkthye në gjuhën e shenjave. Organizatat e shoqërisë civile që avokojnë për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara zhvilluan trajnime për partitë politike se si të adresojnë nevojat e personave me aftësi të kufizuara, për shembull duke i bërë ueb-faqet e tyre më të arritshme. MPVZ-ja e ODIHR-it u informua se vetëm një person me aftësi të kufizuar ishte kandidat në këto zgjedhje, në një pozicion në listën e partisë që pothuajse nuk kishte gjasa për të fituar.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat zgjedhore mund të financohen nga donacione monetare dhe kontribute në natyrë nga individë dhe persona juridikë, në shuma deri përkatësisht 3.000 euro dhe 30.000 euro, anëtarësi dhe kredi bankare të dedikuara për fushatën zgjedhore. Donacionet nga burime të huaja, komunale dhe anonime, ato nga organizatat në pronësi shtetërore, organizatat fetare, bamirëse dhe mediat janë të jashtëligjshme. Shpenzimet e fushatës janë të kufizuara në rreth 110 denarë (afërsisht 2 euro) për votues të regjistruar në një njësi zgjedhore (minimum 490.830 euro në njësinë zgjedhore 3 dhe maksimum 544.930 euro në njësinë zgjedhore 1).⁴⁶ Reklamata e paguara politike në mediat transmetuese, të shkruara dhe në ato online financohen drejtpërdrejt nga shteti përmes një fondi të veçantë që administrohet nga KSHZ-ja (Shih seksionin *Mediat*). Partitë politike që marrin më shumë se një për qind të votave kanë të drejtë për financim publik.⁴⁷

Financave të fushatës iu kushtua vëmendje e kufizuar në narrativat e fushatës së garuesve.⁴⁸ Edhe kushtet e pazakonta për zhvillimin e fushatës në kohë pandemie patën ndikim në financimin e fushatës. Garuesit në zgjedhje e informuan MPVZ-në e ODIHR-it se përmbajtja nga tubimet e mëdha parazgjedhore solli një kursim të konsiderueshëm, veçanërisht pasi shmangu nevojën për të transportuar mijëra mbështetës në vendet e tubimeve. Megjithatë, shpenzimet e prodhimit të reklamave në media dhe përdorimi i madh i posterëve në bilborde paraqitën shpenzime të konsiderueshme.

Financimi i fushatës rregullohet me Kodin Zgjedhor, Ligjin për Financimin e Partive Politike, Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktin e Interesave (LPKKI), dhe me Ligjin për Kontabilitetin

⁴⁶ Një euro është mesatarisht e barabartë me 61 *denarë* (MKD).

⁴⁷ Të paktën një për qind e votave të fituara në zgjedhjet e fundit parlamentare në gjithë vendin ose në zgjedhjet e fundit lokale në një njësi të vetëqeverisjes lokale. Sipas ndryshimit të vitit 2018 në Ligjin për Financimin e Partive Politike, subvencionet publike për partitë politike u rritën nga 0.06 për qind në 0.15 për qind të pjesës së të ardhurave të buxhetit vjetor (nga 1.8 milion në 4,5 milion euro). Sipas Ligjit, 70 për qind do të shpërndahen midis dy partive më të mëdha parlamentare në përpjesëtim me numrin e deputetëve. Megjithatë, në vitin 2020, qeveria i zvogëloi pagesat nga buxheti për partitë politike si masë kursyese e lidhur me KOVID-19.

⁴⁸ Në vitin 2019, Maqedonia e Veriut [shënoi rezultatin](#) 35 nga 100 pikë të mundshme dhe u rendit e 106-ta nga 198 vende në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Siç është theksuar në [Raportin e Pestë të Vlerësimit të GRECO-s të vitit 2019 për Maqedoninë e Veriut](#), "një procedurë e moszbatimit u iniciua në qershor të vitit 2018 si rezultat i rezultateve të dobëta: deri më sot vetëm 31% e rekomandimeve janë zbatuar plotësisht, 42% janë zbatuar pjesërisht dhe 26% mbeten të pazbatuara".

e Organizatave Jofitimprurëse. Korniza ligjore për financimin e fushatës kërkon një harmonizim të mëtejshëm për të eliminuar zbrastëritat dhe mospërputhjet dhe për të ofruar qartësi ligjore. Në veçanti, harmonizimi i Kodit Zgjedhor me Ligjin për Financimin e Partive Politike është i domosdoshëm për të unifikuar vlerën e lejuar të donacioneve për qëllime fushate në llogaritë e fushatës dhe të partive. Shuma aktuale e donacioneve të lejuara për partitë politike e tejkalon shumë e lejuar për qëllime fushate, e cila u përdor nga disa garues për t'i anashkaluar kufizimet e shpenzimeve. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor parashikuan detyrimin që raportet e fushatës të jenë në përputhje me dispozitat e Ligjit për Kontabilitetin e Organizatave Jofitimprurëse, i cili nuk parashikon raportimin e kontributeve në natyrë, gjë që çon në kundërshtime ligjore.⁴⁹ Kodi Zgjedhor nuk përmban më dispozita të zbatueshme për kompensimin shtetëror për shpenzimet e fushatës për garuesit, gjë që e dëmton qartësinë ligjore, veçanërisht në lidhje me përcaktimin e sanksioneve për shkeljen e rregullave për raportimin e financimit të fushatës.⁵⁰

Ligji nuk thotë gjë për përdorimin e kredive për qëllime të fushatës, si dhe për përcaktimin e çmimit të tregut të mallrave të dhuruara, shërbimeve dhe zbritjeve, dhe garuesit raportuan shumat e përcaktuara nga marrëveshjet me ofruesit e shërbimeve.⁵¹ Për më tepër, nuk ka masa për të siguruar se të gjitha faturat e lidhura me fushatën do të dorëzohen para afatit të fundit për mbylljen e llogarive të fushatës.

Dispozitat ligjore në lidhje me donacionet duhet të rishikohen në mënyrë që të harmonizohen kufizimet e donacioneve, për të siguruar transparencën dhe kufizimet e kredive të marra nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe për të krijuar një mekanizëm për të përcaktuar çmimin e tregut të kontributeve në natyrë.

Me ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor u parashikua që një raport shtesë i përkohshëm të dorëzohet 19 ditë pas ditës së zgjedhjeve dhe u shkurtua afati i fundit për dorëzimin e raportit përfundimtar nga katër në tre muaj pas zgjedhjeve; kjo periudhë mbetet dukshëm më e gjatë sesa periudha e rekomanduar nga praktika e mirë ndërkombëtare.⁵² Duhet të dorëzohen edhe dy raporte të përkohshme para ditës së zgjedhjeve: një në mes të fushatës, dhe një tjetër një ditë para zgjedhjeve, gjë që nuk lejon kohë për shqyrtim të detajuar ose për publikim para zgjedhjeve, në kundërshtim me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it. Vetëm raportet përfundimtare i nënshtrohen revizionit të detyrueshëm. Ligji nuk përcakton në hollësi përmbajtjen e raporteve, duke e transferuar përgjegjësinë për adresimin e mungesës së qartësisë dhe për të siguruar cilësi të përshtatshme të raporteve tek Ministria e Financave, e cila zhvilloi shabllonet për raportim. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) dorëzon një raport mbi financimin e fushatës në Kuvend tre muaj pas zgjedhjeve, dhe për këtë arsye nuk mund t'i pasqyrojë gjetjet e revizionit, të cilat duhet të dorëzohen nga ESHR-ja brenda 60 ditëve nga dorëzimi i raportit përfundimtar.

Dispozitat e paqarta për raportimin e përkohshëm shkaktuan interpretime të ndryshme të diapazonit të tyre. Shumica e pjesëmarrësve të fushatës e vlerësuan kornizën e raportimit të përkohshëm si të ngarkuar, duke pasur parasysh se tre raporte të përkohshme duhet të dorëzohen në intervale të shkurtra

⁴⁹ Pozitivisht, kjo u zgjidh nga Ministria e Financave, e cila i përfshiu kontributet në natyrë në shabllonin e raportit.

⁵⁰ Megjithatë neni 86 mbi kompensimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore në bazë të numrit të votave të fituara u shfuqizua nga Kodi Zgjedhor në vitin 2018, nenet 87, 88 paragrafi 3, dhe dispozitat përkatëse ndëshkuese të Kodit Zgjedhor, që parashikojnë se kundërvajtjet sjellin humbje të pjesshme ose të plotë të kompensimit të shpenzimeve të fushatës ose pezullim të pagesës, mbeten të pandryshuara.

⁵¹ Shih paragrafët 171 dhe 198 të [Udhëzimeve të ODIHR-it dhe të Komisionit të Venedikut mbi Rregulloren për Partitë Politike](#) dhe nenin 12 të [Rekomandimit të vitit 2003](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për vendet anëtare mbi rregullat e përbashkëta kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore.

⁵² Paragrafi 200 i Udhëzimeve të ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut për Rregulloren e Partive Politike rekomandon që "[r]aportet për financimin e fushatës duhet t'u dorëzohen autoriteteve kompetente brenda një periudhe jo më shumë se 30 ditë pas zgjedhjeve".

kohore në tre institucione (KSHZ, KSHPK dhe ESHR). Detyrimi për publikimin periodik të donacioneve u respektua në mënyrë efektive nga 9 garues nga 15 gjithsej, ndërsa KSHZ-ja nuk i publikoi raportet e përkohshme të garuesve në mënyrë konsekuente, gjë që e zvogëloi transparencën. Raporti i dytë për donacionet u dorëzua nga 10 garues nga 15 gjithsej, të cilët raportuan kryesisht donacione private dhe pagesa për anëtarësim.⁵³ Shumica e garuesve e intensifikuan mbledhjen e mjeteve financiare në gjysmën e dytë të fushatës dhe të gjithë u mbështetën në donacione individuale në llogaritë e partisë dhe të fushatës.⁵⁴ Mospërdorimi nga ana e disa pjesëmarrësve i modeleve të përcaktuara të raportimit e bëri të paqartë origjinën e fondeve të transferuara nga llogaritë e partive politike, gjë që e dëmtoi shpalosjen e njëtrajtshme. Pavarësisht nga detyrimet ligjore, vetëm disa garues i publikuan raportet e tyre në ueb-faqet e tyre. Raportet e treta të përkohshme nuk u publikuan.

Kodi Zgjedhor duhet të kërkojë që raportet e financimit të fushatës të dorëzohen dhe të publikohen në ditën e dorëzimit në format të njëtrajtshëm, të përshtatshëm për shqyrtim publik, dhe të shoqëruara me dokumentacionin financiar mbështetës. Sanksionet për dorëzimin me vonesë ose për mosdorëzimin duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare duhet të përshtatet për të qenë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Në vitin 2020, Kodi Zgjedhor u përafrua me LPKKI-në, duke e zhvendosur juridiksionin parësor për mbikëqyrjen e financimit të fushatës dhe keqpërdorimin e burimeve administrative të KShPK-ja. KShPK-ja ka për detyrë të kryejë monitorim të vazhdueshëm të financimit të fushatës gjatë gjithë periudhës zgjedhore, duke përfshirë aktivitetet financiare të partive politike dhe të zyrtarëve publikë, dhe të kërkojë të dhëna nga bankat dhe institucionet e tjera kompetente. Organi ka të drejtë të fillojë inspektime sipas detyrës zyrtare dhe t'i shqyrtojë kundërshtimet nga personat fizikë dhe juridikë, duke përfshirë nga garuesit, partitë dhe vëzhguesit e zgjedhjeve, dhe të iniciojë ndjekje penale në rast shkeljesh dhe si reagim ndaj raporteve të ESHR-së. ESHR-ja bën kontroll të mëvonshëm (*ex-post*) të financimit të fushatës duke u bazuar në revizionin e raportit përfundimtar.

Në bazë të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor, bankat janë të detyruara që KSHPK-së dhe ESHR-së t'i lejojnë qasje në transaksionet në llogaritë e fushatës deri në mbylljen e llogarive. Megjithatë, e drejta për qasje nuk vlen për llogaritë e zakonshme të partive, megjithëse mjetet e tyre mund të përdoren për fushatën zgjedhore, si dhe nuk është paraparë ofrimi i të dhënave financiare pas mbylljes së llogarive, gjë që do ta ndihmonte rishikimin për ta lehtësuar revizionin. Të gjitha palët e interesuara janë të detyruara të sigurojnë dokumentacione financiare me kërkesë të ESHR-së, duke kontribuar kështu për një revizion gjithëpërfshirës të bazuar në prova. Megjithëse këto ndryshime e afrojnë mbikëqyrjen e financimit të fushatës me rekomandimet e ODIHR-it dhe GRECO-s, duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme për të përmirësuar transparencën dhe llogaridhënien në financimin politik dhe të fushatës.

⁵³ Ligji përcakton dënime me burg deri në pesë vjet për mosdorëzimin e raporteve të financimit të fushatës, por ato nuk zbatohen. [Rekomandimi i vitit 2003](#) i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për vendet anëtare mbi rregullat e përbashkëta kundër korrupsionit në financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore kërkon që "... shkelja e rregullave në lidhje me financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore duhet t'i nënshtrohet sanksioneve efektive, proporcionale dhe dekurajuese"

⁵⁴ Për shembull, për gjysmën e fushatës, koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja raportoi 1 donacion nga një individ prej rreth 580 eurosh dhe një kontribut në natyrë prej rreth 1.000 eurosh, BDI raportoi donacione për partinë në mallra dhe shërbime prej rreth 530 eurosh, PDSH-ja - donacione në para nga individë prej rreth 12.600 eurosh, Levica raportoi donacione prej 42.145 eurosh, por nuk përmendi donatorë, koalicioni Aleanca për Shqiptarët - AlternativA raportoi donacione prej 96.330 eurosh të transferuara nga llogaria e partisë. Raporti i dytë tregon kryesisht donacione individuale në llogaritë e fushatave dhe të partive, të pranuar nga koalicioni i LSDM-së prej 226.620 eurosh, BDI-ja - 72.577 euro, PDSH-ja - rreth 4.000 euro dhe Levica - 170 euro. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja me donacione prej rreth 396.883 eurosh, kryesisht të transferuara nga llogaria e partisë në llogaritë e fushatës, dhe 134.347 euro për gjysmën e dytë të fushatës.

Institucionet që kanë për detyrë të bëjnë mbikëqyrjen e fushatës kanë mungesë kapaciteti për shkak të burimeve të pamjaftueshme financiare dhe njerëzore, që e dëmtoi kontrollin mbi llogaridhënien dhe transparencën e financimit të fushatës.⁵⁵ Për këto zgjedhje, KSHPK-ja ishte në komunikim me shoqërinë civile për të marrë informacione lidhur me dyshimet për shkelje. Për më tepër, Komisioni e forcoi mbikëqyrjen e tij të fushatës me 17 vëzhgues shtesë në terren, të pajisur me ndihmë ndërkombëtare për shkak të mungesës së fondeve të nevojshme shtetërore, të cilët mblodhën prova mbi aktivitetet e fushatës. Megjithatë, gjetjet e vëzhguesve nuk u bënë publike, duke humbur kështu mundësinë për të rritur transparencën.

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Enti Shtetëror për Revizion duhet të pajisen me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ta realizuar në mënyrë efektive mandatin e tyre gjatë periudhës zgjedhore.

Kodi Zgjedhor përmban dispozita të hollësishme që parashikojnë përdorimin e barabartë të hapësirave publike dhe ndalon keqpërdorimin e burimeve shtetërore. Pas shpalljes së zgjedhjeve, nuk mund të bëhen pagesa rrogash, pensionesh dhe ndihmash sociale, përveç pagesave të zakonshme, nga mjetet buxhetore. Me përjashtim të rasteve urgjente, punësimi i punonjësve të rinj në sektorin publik ose ndërprerja e punësimit të punonjësve ekzistues është e ndaluar. Një ndryshim i fundit ofron sqarime se cilat janë rastet e tilla urgjente. Megjithatë, të gjitha këto rregulla u pezulluan me një dekret të qeverisë për kohëzgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme.

X. MEDIAT

A. AMBIENTI MEDIATIK

Një numër i madh mediash, duke përfshirë 11 televizione kombëtare dhe 36 private rajonale, konkurrojnë në një treg të vogël reklamash dhe kanë mungesë të qëndrueshmërisë financiare, rregullatore dhe profesionale, gjë që kontribuon në polarizimin e ambientit mediatic. Reklamata qeveritare, të cilat kishin shërbyer si burim kryesor i të ardhurave për shumë media, janë të ndaluara që nga viti 2017. Stagnacioni i vazhdueshëm në tregun e reklamave, shkaktuar nga pandemia e KOVID-19, ka rritur më tej varësinë e mediave nga pronarët dhe subvencionet shtetërore.⁵⁶

Të gjithë bashkëbiseduesit e MPVZ-së së ODIHR-it vlerësuan se përmirësimet e konsiderueshme në lirinë e mediave në vitet e fundit nuk u mbështetën me reforma sistematike në sektorin e mediave, siç është sigurimi i neutralitetit politik të Radiotelevizionit publik të Maqedonisë (RTM) dhe i organit rregullator të mediave. Bashkëbiseduesit theksuan shumëllojshmërinë e përmirësuar të mbulimit të lajmeve, por vunë gjithashtu në dukje një nivel të ulët profesionalizmi, fokusin redaktues në sasinë e

⁵⁵ Paragrafi 220 i [Udhëzimit për Rregulloren për Partitë Politike i ODIHR-it dhe i Komisionit të Venedikut të vitit 2011](#) thotë se "Në përgjithësi, legjislativi duhet t'u ofrojë mundësinë organeve rregullatore të hetojnë dhe të ndjekin shkeljet e mundshme. Pa kompetenca të tilla hetimore, këto organe nuk kanë mundësi ta zbatojnë në mënyrë efektive mandatin e tyre. Gjithashtu nevojitet financim adekuat për të siguruar funksionimin e duhur të organit rregullator". [Raporti i Pestë i Vlerësimit i GRECO-s i vitit 2019 për Maqedoninë e Veriut](#) arriti në përfundimin se "fuqia e përgjithshme e kornizës kundër korrupsionit është e diskutueshme [për shkak të zbatimit selektiv], ndërsa ndryshimet e shpeshta të ligjeve kanë krijuar një mjedis në përgjithësi të paparashikueshëm [...]".

⁵⁶ Qeveria kalimtare prezantoi disa iniciativa që kishin për qëllim të mbështesin mediat gjatë pandemisë, ndër të tjera duke i mbuluar shpenzimet e digjitalizimit për pesë televizione kombëtare dhe gjashtë rajonale dhe duke i subvencionuar kontributet sociale të punonjësve të mediave në buxhetin e shtetit. Në mars të vitit 2020, organi rregullator i medias, ASHAAM-i, hoqi dorë nga tarifa vjetore e licencës për të gjithë transmetuesit për dy vjet.

përmbajtjes e jo në cilësinë e saj.⁵⁷ Shumë bashkëbisedues ngritën shqetësimin se pandemia e KOVID-19 kontribuoi në përkeqësimin e kushteve tashmë të vështira të punësimit të gazetarëve.

Televizioni mbetet burimi kryesor i informimit, e më pas vijnë mediat online. Në prill të vitit 2020, RTM-ja e rriti numrin e kanaleve televizive nga dy në pesë, duke rivendosur RMT-2 si shërbim 24 orësh në gjuhën shqipe, si dhe duke krijuar një kanal që transmeton programe në gjuhët e pakicave, edhe atë në boshnjakisht, gjuhën rome, serbisht, turqisht dhe vllahisht. Përkundër futjes së subvencioneve shtetërore në vitin 2018 për shtypjen dhe shpërndarjen e gazetave kombëtare dhe rajonale, qarkullimi i medias së shkruar ka rënë në mënyrë të vazhdueshme.

RTM-ja financohet pothuajse ekskluzivisht nga buxheti i shtetit që nga viti 2017, gjë që, sipas bashkëbiseduesve të MPVZ-së së ODIHR-it e dëmton pavarësinë e saj redaktuese.⁵⁸ Këshilli Programor mbikëqyr përmbajtjen e RTM-së dhe emëron Këshillin Mbikëqyrës që është përgjegjës për mbikëqyrjen e tij financiare. Të dy institucionet perceptohen tradicionalisht si të ndikuara politikisht, kurse kompetencat e tyre janë të kufizuara, pasi mandatet e anëtarëve të tyre kanë skaduar.⁵⁹

Për të garantuar pavarësinë politike, transmetuesi publik duhet t'i nënshtrohet një sërë reformash, duke përfshirë ndryshimin e procedurës për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Programor dhe uljen e varësisë së tij nga buxheti i shtetit. Reformat e mëtejshme të transmetuesit publik duhet të synojnë përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së prodhuar nga vetë transmetuesi, duke përfshirë gazetarinë hulumtuese dhe atë analitike.

Një numër bashkëbiseduesish të MPVZ-së së ODIHR-it ngritën shqetësimin e tyre në lidhje me shpërndarjen e informacionit mashtrues ose të rremë në mediat online dhe ato sociale. Për të adresuar këtë çështje, disa organizata të njohura profesionale të medias krijuan një regjistër të mediave profesionale online, të cilat zotohen t'i përmbahen standardeve profesionale; një numër i kufizuar i mediave online iu bashkua kësaj iniciative.⁶⁰

B. KORNIZA LIGJORE

Kodi Zgjedhor parashikon rregullore të hollësishme për sjelljen e mediave, duke filluar nga shpallja e zgjedhjeve e deri në përfundimin e fushatës. Të gjithë transmetuesit dhe ueb-faqet që i mbulojnë zgjedhjet kërkohet që ta bëjnë këtë në një mënyrë të drejtë, të ekuilibruar dhe të paanshme. Ekuilibri proporcional duhet të bazohet në numrin e njësive zgjedhore në të cilat garojnë garuesit, si dhe në intensitetin e aktiviteteve të tyre të fushatës. Një ndryshim që u bë në Kodin Zgjedhor në shkurt të vitit 2020 kërkoi nga transmetuesit kombëtarë që ta plotësojnë mbulimin zgjedhor edhe me interpretim në gjuhën e shenjave; të gjithë transmetuesit e monitoruar nga MPVZ-ja e ODIHR-it nuk e respektuan këtë, gjë që ASHAAM-i ia atribuoi kohës së kufizuar për ta zbatuar këtë dispozitë.⁶¹

⁵⁷ [Raporti i Komisionit Evropian i viti 2019 mbi Maqedoninë e Veriut](#) vuri në dukje përmirësime në sferën publike në lidhje me lirinë e mediave dhe lirinë e shprehjes, debatin e vazhdueshëm të hapur politik dhe raportimin kritik të mediave. Megjithatë, në të theksohet nevoja për ta përmirësuar pavarësinë, përshtatshmërinë financiare, standardet profesionale dhe cilësinë e gazetarisë, veçanërisht në mediat publike.

⁵⁸ Në vitin 2019, rreth 96 për qind e [buxhetit](#) të RTM-së u financua nga buxheti i shtetit.

⁵⁹ Mandati i Këshillit Programor skadoi në dhjetor të vitit 2019, ndërsa anëtarët e rinj nuk u emëruan nga Kuvendi për shkak të bllokimit politik. Mandati i anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës gjithashtu ka skaduar në mars të vitit 2020. Për rekomandimet mbi Mbikëqyrjen e Transmetuesit Publik shih Paragrafët 13-49 të [Rekomandimit të Komitetit të Ministrave \(KMKE\) CM/Rec\(2012\)1 të Këshillit të Evropës](#).

⁶⁰ Për t'u regjistruar në Regjistrin e mediave profesionale onlajn, mediat duhet t'i respektojnë standardet profesionale dhe të sigurojnë informata për financimin, pronësinë dhe ekipin redaktues. Deri më 15 korrik të vitit 2020, në këtë regjistër ishin regjistruar 134 ueb-faqe.

⁶¹ Paragrafi 7.4.2 i [Rezolutës 2155 \(2017\)](#) të APKE-së u bën thirrje vendeve pjesëmarrëse të "Sigurojnë sigurimin e informacionit në lidhje me proceset zgjedhore, procedurat e votimit dhe programet politike në formate të qasshme,

Lajmet e *RTM-së* gjatë fushatës i nënshtrohen rregullimit të përpiktë sa i përket sasisë së mbulimit kushtuar partive në pushtet, opozitës parlamentare dhe në një masë më të vogël partive joparlamentare dhe kandidatëve të pavarur. Duke qenë se ligji kërkon që t'u kushtohet kohë e barabartë mbulimi partive në pushtet dhe atyre opozitare si grupe, e jo si parti individuale, mbulimi i kombinuar i LSDM-së, BDI-së dhe PDSH-së duhej të ishte identik me mbulimin e kombinuar në lajme të koalicioneve opozitare - VMRO-DPMNE-së dhe koalicionit të Aleancës për Shqiptarët (ASH) me *Alternativën*. Transmetuesi publik i respektoi detyrimet, megjithëse RTM-ja dhe bashkëbiseduesit e tjerë të MPVZ-së së ODIHR-it i kritikuan rregulloret si të tepërta dhe minuese të pavarësinë redaktuese.⁶²

Dispozitat që rregullojnë lajmet e transmetuesit publik gjatë fushatës duhet të rishikohen, me qëllim që të sigurohet liria redaktuese, pluralizmi i pikëpamjeve dhe mundësitë e barabarta për garuesit.

Kodi Zgjedhor e urdhëron *RTM-në* të ndajë kohë falas për garuesit midis orës 16:00 dhe 23:00. Gjashtë parti vendosën të paraqiten në *RTM-1* dhe dy parti në *RTM-2*. Në të dy kanalet, koha falas e garuesve ishte e kufizuar në fjalime të xhiruara më parë në ambientet e RTM-së, pasi xhirimet e prodhuara nga vetë garuesit nuk u lejuan.

Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, reklamat e paguara politike në mediat private transmetuese, të shkruara dhe ato online mbuloheh ekskluzivisht nga buxheti i shtetit. Kodi Zgjedhor e rregullon ndarjen e mjeteve financiare për reklama të paguara politike dhe i përcakton kufizimet kohore për reklamat e tilla brenda çdo ore të transmetimit.⁶³ Megjithatë, kjo formulë për ndarjen e kohës dhe të mjeteve financiare nuk ishte parashikuar nga korniza rregullatore.⁶⁴

Më 22 qershor, në ditën e fundit të gjendjes së jashtëzakonshme, qeveria i ndryshoi dispozitat mbi alokimin dhe shpërndarjen e mjeteve financiare dhe kufizimet kohore për reklamat e paguara politike, duke përfshirë rritjen e shumës së lejuar të reklamave të paguara politike për orë reale. Tre garues, koalicionet e udhëhequra nga LSDM-BESA, VMRO-DPMNE-ja dhe BDI-ja, ishin në avantazh të konsiderueshëm pasi kishin të drejtë të shpenzonin vetëm për qëllime të reklamave të paguara politike rreth 800,000 euro secili, ndërsa dymbëdhjetë garuesit e tjerë kishin të drejtë për rreth 30,000 euro secili. Rregullimi i tepërt ekzistues së bashku me ndryshimet e përsëritura të kornizës ligjore krijuan paqartësi ligjore, ndërsa shpërndarja joproporcionale e kohës dhe e mjeteve financiare i kufizoi ndjeshëm mundësitë për fushatë të drejtpërdrejtë për dymbëdhjetë garues, pasi ata nuk mund të përdornin mjete të tjera financiare për të blerë reklama politike të paguara, përveç atyre që u ishin siguruar nga shteti.⁶⁵

duke përfshirë në versione të lexueshme lehtë dhe të kuptueshme lehtë, me interpretim në gjuhën e shenjave kur kërkohet, me titra për videot dhe me versione në alfabetin e Brejtit”.

⁶² Paragrafi 16 i [Komentit të Përgjithshëm Nr. 34](#) i KNDCP-së u kërkon shteteve të garantojnë pavarësinë dhe lirinë redaktuese të mediave publike. Për më tepër, Paragrafi I.3 i Rekomandimit [CM/Rec \(2007\)15](#) të KMKE-së thotë, “Kornizat rregullatore për mbulimin mediatik të zgjedhjeve duhet të respektojnë pavarësinë redaktuese të mediave”.

⁶³ Çdo garuesi i ndahen nga 2 euro për votues të regjistruar dhe ato shpërndahen sipas përqindjeve të mëposhtme: deri në 45 për qind dhe deri në katër minuta në orë të transmetimit do t'u ndahen dy partive më të mëdha në pushtet, dhe deri në 45 për qind dhe deri në katër minuta në orë të transmetimit dy partive më të mëdha parlamentare të opozitës. Partitë e tjera parlamentare dhe joparlamentare dhe kandidatët e pavarur nuk marrin më shumë se 10 përqindëshin e mbetur të mjeteve financiare dhe deri në një minutë në orë të transmetimit.

⁶⁴ KSHZ-ja i ngriti shqetësime MPVZ-së së ODIHR-it lidhur me mungesën e qartësisë në ndryshimet e bëra për sa i përket identifikimit dhe shpërndarjes së mëvonshme të mjeteve për Lëvizjen BESA, pasi kjo parti, megjithëse zyrtarisht ishte në opozitën parlamentare, formoi një koalicion parazgjedhor me LSDM-në në pushtet.

⁶⁵ Paragrafi II.5 i Rekomandimit [CM/Rec\(2007\)15](#) të KMKE-së rekomandon se “Kornizat rregullatore duhet të sigurojnë që të gjitha palët garuese të kenë mundësinë e blerjes së hapësirës reklamuese në dhe sipas kushteve dhe çmimeve të barabarta”.

Rregulloret për reklamën e paguara politike në media duhet të rishikohen, në mënyrë që të lejohet qasja e papenguar në media mbi baza jodiskriminuese.

Nga të gjitha mediat që ishin të interesuara për të shitur hapësirë për reklama të paguara politike u kërkuar të regjistroheshin në KSHZ.⁶⁶ Në mungesë të kërkesave dhe udhëzimeve formale për regjistrimin e mediave, nuk u bë asnjë verifikim i informacionit të dorëzuar. Rrjedhimisht, disa transmetues që nuk ishin të licencuar në Maqedoninë e Veriut morën regjistrime, të cilat më pas u revokuan pas njoftimit nga organi rregullator i medias. Në mungesë të një përkufizimi të qartë të mediave online, disa ueb-faqe regjistruan edicione në gjuhë në ndryshme ose domene të ndryshme të së njëjtës ueb-faqe si media të veçanta, duke e anashkuar kufirin ligjor të shumës për shpenzime për reklama për një garues në një medie të shkruar ose online (15.000 euro). Për më tepër, bashkëbiseduesit e MPVZ-së së ODIHR-it vërejtën një numër të lartë mediash të reja të panjohura të regjistruara.⁶⁷

Për të siguruar transparencën e pronësisë së mediave dhe të shpenzimeve të fushatës, mediat online të interesuara për të shitur hapësirën e tyre për reklama të paguara politike duhet të respektojnë disa kërkesa themelore të transparencës, duke përfshirë informacionin e verifikueshëm mbi pronësinë dhe financimin.

Ndryshimet e bëra në shkurt të vitit 2020 në Kodin Zgjedhor përcaktuan se shuma maksimale që mund t'i paguhej cilësdo medie për reklama politike nuk mund ta tejkalojë çmimin mesatar të reklamimit që është përdorur gjatë pesë zgjedhjeve mëparshme. Çmimet maksimale për të gjitha mediat u llogaritën nga KSHZ-ja, organi përgjegjës për pagimin e subvencioneve shtetërore për mediat, në bazë të çmimeve të reklamave të dhëna nga ato media që ofruan hapësirën e tyre në pesë zgjedhjet e fundit.⁶⁸ Dispozitat janë të pafavorshme për transmetuesit me audiencën më të lartë, që janë të detyruar të respektojnë çmimet e ndikuara nga çmimet mesatare të transmetuesve më të vegjël rajonalë dhe nuk lejojnë asnjë përshtatje për shkak të zhvlerësimeve ekonomike. Pesë televizione kombëtare e kontestuan pa sukses formulën e KSHZ-së në Gjykatën Administrative (Shih *Kundërshtimet dhe Ankesat*).

Reklamën politike në platformat ndërkombëtare të reklamave në internet si Google AdSense dhe në mediat sociale nuk janë të rregulluara në mënyrë të veçantë. Përderisa partitë politike i përdorën gjerësisht këto metoda fushate, mungesa e transparencës së mjeteve të tilla e bën të pamundur revizionin thelbësor.⁶⁹

Respektimi i Kodit Zgjedhor nga ana e transmetuesve u mbikëqyr nga ASHAAM-i. Gjatë monitorimit të mbulimit të fushatës, ASHAAM-i arriti në përfundimin se të gjithë transmetuesit privatë ishin përqendruar kryesisht në partitë parlamentare, në kundërshtim me kërkesat e Kodit Zgjedhor. Këshilli i ASHAAM-it sanksionoi vetëm televizionin *Alsat-M* dhe TV *Shenja* për shkak se nuk siguruan asnjë

⁶⁶ Për këto zgjedhje, KSHZ-ja regjistroi 44 stacione televizive, 52 radiostacione, 12 media të shkruara dhe 230 ueb-faqe.

⁶⁷ KMKE-ja në [Udhëzimet mbi pluralizmin e medias dhe transparencën e pronësisë së mediave](#) (Rekomandimi CM/Rec(2018)1 kërkon që vendet pjesëmarrëse të promovojnë transparencën e pronësisë së mediave (Paragrafi 4.4 - 4.7) duke përfshirë shpalsjen e emrave dhe kontaktet e pronarëve të drejtpërdrejtë, aksionarëve përfitues, dhe personave me përgjegjësi aktuale redaktuese dhe shpalsjen nga mediat të marrëdhënieve kontraktuese me media të tjera ose kompani reklamuese dhe parti politike që mund të kenë ndikim në pavarësinë redaktuese.

⁶⁸ KSHZ-ja [vendosi](#) të përdorë një çmim mesatar duke u bazuar në listat e çmimeve të mëparshme të gjashtë televizioneve kryesore kombëtare, tre radiove kombëtare dhe tre gazetave ditore si bazë për llogaritjet e saj. Më 16 shkurt, KSHZ-ja përcaktoi se çmimi maksimal për një reklamë të paguar politike në televizion është 1.83 euro për sekondë, në radio 0.66 euro për sekondë, në mediat e shkruara 405 euro për një faqe bardhë e zi dhe 530 euro për një faqe me ngjyra.

⁶⁹ Edhe pse më 6 mars të vitit 2020, Facebook-u [shpalli](#) një zgjerim të rregullave të tyre të transparencës së reklamave në 32 vende shtesë, duke përfshirë Maqedoninë e Veriut, për shkak të pandemisë së COVID-19 zbatimi i tyre u [shty](#) deri më 5 gusht 2020

mbulim të partive joparlamentare dhe për mbulimin sistematik negativ të njërit prej pjesëmarrësve në zgjedhje, megjithatë zgjodhi të mos sanksiononte TV *Alfa* që mbulonte gjithashtu një nga garuesit negativisht.⁷⁰ ASHAAM-i gjithashtu filloi tre procedura kundërvajtëse për shkeljen e periudhës së heshtjes zgjedhore; dy rezultuan me gjoba dhe një u shpall i pafajshëm nga Gjykata Administrative. Gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, një numër partish politike vazhduan të reklamojnë në mediat online dhe mediat sociale, të cilat nuk u monitoruan në mënyrë aktive nga asnjë institucion publik.

Agjencia gjithashtu verifikoi praninë e reklamave të paguara politike në medien transmetuese, të cilat paguhen nga KSHZ-ja. Të dhënat e ASHAAM-it për monitorimin e reklamave politike treguan se disa garues shpenzuan më shumë se kufijtë ligjorë.⁷¹ Në fund të shtatorit, KSHZ-ja e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se kishte kompensuar shumicën e mediave, ndërsa një numër shumë i vogël që kishin mbetur pa paguar do të duhej të ndreqnin gabimet teknike në dokumentacionin e tyre në mënyrë që të paguheshin. Kodi Zgjedhor nuk parashikon asnjë sanksion për garuesit zgjedhorë, të cilët, duke nënshkruar kontrata me mediat, i tejkalojnë kufijtë ligjorë. Nuk u krye asnjë verifikim ose monitorim i mediave online. Në një numër rastesh, ASHAAM-i identifikoi reklama të paguara politike që shfaqnin të mitur, në kundërshtim me Kodin Zgjedhor. Megjithëse përgjegjësia për përmbajtjen e reklamave u takon me ligj vetëm mediave, ASHAAM-i zgjodhi të mos vendoste sanksione, por ua kujtoi dy herë formalisht transmetuesve ndalimin. Mediat i ngritën shqetësime MPVZ-së së ODIHR-it se brenda kornizës aktuale garuesit nuk kanë motivim të drejtpërdrejtë për të shmangur shkelje të tilla.

Partitë politike, si prodhuese të reklamave politike, duhet të jenë ligjërishit përgjegjëse për përmbajtjen e tyre.

C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

Monitorimi i fushatës zgjedhore në media nga ana e MPVZ-së së ODIHR-it doli në përfundimin se lajmet e të gjithë transmetuesve kombëtarë siguruan një mbulim sipërfaqësor të aktiviteteve të fushatës, të cilat ishin nën hije të akuzave të ndërsjella, si dhe të pasojave të regjistrimeve të publikuara të liderëve politikë.⁷² Raportimi i thelluar analitik ose diskutimet për politikën kryesisht mungonin në mbulimin e fushatës, duke ua kufizuar votuesve mundësinë për të bërë një zgjedhje të informuar mes alternativave të veçanta politike.

Pavarësisht nga kufizimet ligjore me të cilat u vendosën kuotat e sakta për mbulim, si *RTM-1* ashtu dhe *RTM-2* shfaqën përpjekje të dukshme për të mbuluar aktivitetet e partive politike joparlamentare mbi kuotën e vendosur prej 10 për qind. Megjithatë, përpikëria e kërkesave ligjore rezultoi në atë që *RTM-1* i kushtoi koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja pak më shumë mbulim, rreth 18 për qind, krahasuar me LSDM-në, të cilës iu kushtua 17 për qind e mbulimit të tillë. Partitë e tjera parlamentare, BDI-ja dhe koalicioni *ASH-AlternAtivA* patën përkatësisht 15 dhe 13 për qind të mbulimit. Toni ishte kryesisht neutral për të gjithë garuesit. *RTM-2* i ka kushtoi gjithashtu rreth 19 për qind të mbulimit VMRO-DPMNE-së, 18 për qind koalicionit *ASH-AlternAtivA*, 17 për qind LSDM-së dhe 15 për qind BDI-së.

Media private u përqendruan kryesisht në partitë politike kryesore, dhe, në një masë më të vogël, në partitë më të vogla parlamentare, ndërsa dukshmëria e partive joparlamentare ishte shumë e ulët. Në

⁷⁰ ASHAAM-i e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se, për shkak të kushteve ekonomike të shkaktuara nga kriza e COVID-19, ajo nisi procedura të tilla për kundërvajtje vetëm kundër dy mediave që i kishin injoruar plotësisht fushatat e të gjithë garuesve jo-parlamentarë.

⁷¹ Sipas ASHAAM-it, në mediat transmetuese Unioni Social Demokratik - Shkup (USD) shpenzoi të paktën 53.5 për qind më shumë, Integra shpenzoi të paktën 11 për qind më shumë, ndërsa koalicioni *ASH-AlternAtivA* të paktën 1.6 për qind më shumë, sesa që kishin të drejtë të shpenzonin për reklama të paguara politike në të gjitha mediat.

⁷² Midis 24 qershorit dhe 12 korrikut, MPVZ-ja e ODIHR-it monitoroi periudhën me shikueshmëri më të madhe (nga ora 18:00 deri 00:00) të shtatë transmetuesve kombëtarë: *RTM-1*, *RTM-2*, *Alfa*, *Alsat-M*, *Kanal 5*, *Sitel* dhe *Telma*.

lajmet e tyre kryesore me shikueshmëri më të madhe, dy transmetues privatë kombëtarë, *Sitel* dhe *Telma*, ofruan përqindje të barabarta, rreth 31 dhe 21 për qind, të mbulimit kryesisht neutral të koalicioneve të udhëhequra përkatësisht nga VMRO-DPMNE-ja dhe LSDM-ja. Një qasje e ngjashme u vu re gjatë dy javëve të para të fushatës në *Kanal 5*, megjithatë, në javën e fundit të fushatës, mbulimi i tij i koalicionit të udhëhequr nga LSDM-ja u rrit në krahasim me atë të VMRO-DPMNE-së, megjithëse toni mbeti kryesisht neutral për të gjithë garuesit.

Nga ana tjetër, *Alfa* e kritikoi ashpër qeverinë dhe LSDM-në në pushtet duke u caktuar përkatësisht 28 dhe 40 për qind të mbulimit kryesisht negativ dhe të paanshëm, ndërsa VMRO-DPMNE-ja mori 19 për qind të mbulimit që ishte kryesisht me ton neutral. Një trend i ngjashëm u vërejt edhe në *Alsat-M*, i cili ofroi mbulim kryesisht negativ të BDI-së prej rreth 32 për qind, dhe mbulim kryesisht neutral dhe negativ të koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja prej rreth 15 për qind, ndërsa koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja kishte mbulim kryesisht neutral dhe pozitiv prej rreth 14 për qind.

Emisionet me pjesëmarrës dhe debatet e shumta, duke përfshirë dy debate midis kryetarëve të dy partive më të mëdha politike, LSDM-së dhe VMRO-DPMNE-së, u përdorën kryesisht nga garuesit si platforma për kritika personale të ndërsjella. Megjithatë, pavarësisht faktit se edhe transmetuesi publik dhe ata privatë bënë përpjekje për t'i përfshirë garuesit në debate, në një numër rastesh garuesit zgjodhën të mos merrnin pjesë në to për shkak të mosmarrëveshjeve në lidhje me partnerët e zgjedhur për debat, vlerësimeve të ulëta ose anshmërisë së perceptuar të transmetuesit që e ka bërë ftesën.⁷³

XI. VËZHguesIT QYTETARË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgim qytetar, partiak dhe ndërkombëtar. Më 19 shkurt, KSHZ-ja miratoi Kodin e sjelljes për vëzhguesit, që është i detyrueshëm për të gjitha grupet e akredituara, i cili u ndryshua më 2 korrik për ta rritur transparencën dhe lirinë e lëvizjes së vëzhguesve. KSHZ-ja akreditoi 2.551 vëzhgues qytetarë dhe 102 vëzhgues ndërkombëtarë brenda afatit kohor. Përfaqësues të disa organizatave të shoqërisë civile dhe të organizatave vëzhguese qytetare, duke përfshirë organizatën e shoqërisë civile "MOST", CIVIL - Qendrën për Liri, dhe *Inkluziva*, i vëzhguan fazat kryesore të procesit zgjedhor, si dhe disponueshmërinë e tyre për personat me aftësi të kufizuara, gjë që kontribuoi në transparencën e procesit. MOST-i gjithashtu bëri nxjerrjen paralele të rezultateve të votimit, rezultatet e të cilit u përputhën ngushtë me përqindjen e pjesëmarrjes dhe rezultatet e shpallura nga KSHZ-ja.

XII. KUNDËRSHTIMET DHE ANKESAT

Ekzistojnë rregullore për mekanizmat për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore, por disa rekomandime të mëparshme të ODIHR-it, duke përfshirë ato që kanë të bëjnë me bazën e kufizuar ligjore dhe afatet kufizuese, mbeten të patrajuara. Shumica e kundërshtimeve në lidhje me zgjedhjet janë në kompetencën e KSHZ-së. Me ndryshimet e fundit në Kodin Zgjedhor, u qartësua juridiksioni i KZK-ve për të përfshirë kundërshtimet e votimit të hershëm dhe në ditën e zgjedhjeve nga votuesit, të cilat u interpretuan në mënyrë kufizuese nga KSHZ-ja se vlenin vetëm për regjistrimin e votuesve. Gjykatat themelore i shqyrtojnë pretendimet në lidhje me shkeljet zgjedhore dhe kundërshtimet nga garuesit për ndërhyrje në aktivitetet e tyre të fushatës, ndërsa KSHPK-ja merret me kundërshtimet në lidhje me financimin e fushatës dhe financimin politik, si dhe me keqpërdorimin e burimeve administrative. Gjykata Administrative është shkalla e fundit e ankimit për shumicën e kundërshtimeve të trajtuara nga KSHZ-ja dhe KSHPK-ja, përveç për vendimet për rastet e papranueshme, të cilat nuk mund të

⁷³ TV *Alfa* e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se LSDM-ja nuk iu përgjigj kërkesave të tyre për të marrë pjesë në debate politike, ndërsa *Kanal 5* vuri në dukje se në javën e fundit të fushatës, VMRO-DPMNE-ja i refuzoi ftesat për të marrë pjesë në të paktën katër debate.

kontestohen. Ajo çka ishte pozitive ishte që në vitin 2020, kompetencat e saj u zgjeruan edhe për vendimet e KSHZ-së për parregullsitë e fushatës.

Votuesit kanë bazë të kufizuar ligjore për të iniciuar konteste zgjedhore, pasi kanë të drejtë të ankohen për shkeljen e të drejtave të tyre individuale të votimit, gjë që kufizon mundësinë për mjete efektive ligjore, në kundërshtim me angazhimet ndërkombëtare.⁷⁴ Parregullsitë zgjedhore dhe rezultatet e zgjedhjeve mund të kontestohen nga parashtruesit e listave të kandidatëve. Vëzhguesit nuk kanë të drejtë të parashtrorjnë kundërshtime në lidhje me vëzhgimin e tyre, por, së bashku me përfaqësuesit e partive, mund t'i shënojnë vërejtjet e tyre për parregullsitë e vëzhguara në procesverbalet e KZ-ve, të cilat mund të kundërshtohen në një fazë të mëvonshme nga parashtruesit e listave. Vërejtjet e tilla kërkohen që kundërshtimet të pranohen si të bazuara. Sipas rregullave të reja, KSHZ-së i kërkohet që t'i hetojë parregullsitë dhe shkeljet e pretenduara para se të marrë vendim për kundërshtimet në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të parashtruesve të listave.

Korniza ligjore duhet të rishikohet për të eliminuar kufizimet e panevojshme të së drejtës për të parashtruar kundërshtime dhe ankesa zgjedhore në mënyrë që të ofrojë mjete efektive juridike.

Afatet kohore për kundërshtimet zgjedhore janë të shkurtra.⁷⁵ Si rregull, aplikantët kanë 24 deri në 48 orë për t'i parashtruar kundërshtimet, gjë që e pengon përgatitjen adekuate të tyre. Kundërshtimet e ditës së zgjedhjeve shqyrtohen brenda katër orësh. Ajo çka ishte pozitive ishte se me ndryshimet e vitit 2020 në Kodin Zgjedhor u zgjat afati kohor për shqyrtimin e kundërshtimeve nga KSHZ-ja në 72 orë dhe u ndryshuan afatet për parashtrimin e kundërshtimeve për shkeljet gjatë votimit, numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.⁷⁶ Gjykatat vendosin për ankesat brenda një afati prej 48 ose 60 orësh. Gjykata Themelore ka 24 orë për të vendosur për rastet e kundërvajtjeve zgjedhore, të cilat rezultuan të vështira për t'u arritur si për ankuesit, ashtu edhe për gjykatat, pavarësisht nga numri i kufizuar i rasteve.⁷⁷ Nuk ka procedurë të shkurtuar për hetimin e krimeve zgjedhore, gjë që e pengon ndjekjen penale efektive dhe sanksionimin e autorëve.⁷⁸

Afatet për parashtrimin dhe zgjidhjen e kundërshtimeve mund të zgjaten që të mundësojnë përgatitje adekuate dhe vendim të peshuar mirë. Duhet konsideruar mundësia për t'i zgjatur afatet për shqyrtimin e rasteve të kundërvajtjes në lidhje me zgjedhjet, në përputhje me praktikën e mira. Duhet të sigurohen procedura të shkurtuara për hetimin e shkeljeve zgjedhore.

⁷⁴ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990](#) thotë se "çdokush do të ketë mjete efektive juridike ndaj vendimeve administrative, për ta garantuar respektimin e të drejtave themelore dhe për ta siguruar integritetin ligjor". Shih po ashtu nenin 2.3(a) të [KNDCP-së të vitit 1996](#). Paragrafi II.3.3.3.f i Kodit të Praktikës së Mirë thekson se "të gjithë kandidatët dhe të gjithë votuesit e regjistruar në zonën përkatëse zgjedhore duhet ta kenë të drejtën e ankimit". Shih po ashtu Paragrafin 18.2 të [Dokumentit të Moskës të OSBE-së të vitit 1991](#) dhe [Rekomandimin Rec\(2004\)20](#) të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative.

⁷⁵ Paragrafi II.3.3 (95) i Raportit Shpjegues të Kodit të Praktikës së Mirë thotë se "afatet kohore duhet të zgjasin aq sa për të garantuar ushtrimin e së drejtës së apelimit, si dhe marrjen e një vendimi të peshuar mirë. Një afat kohor prej tri deri në pesë ditë në instancën e parë (duke përfshirë parashtrimin e apelimit dhe marrjen e vendimit) duket se është i arsyeshëm".

⁷⁶ Sipas nenit 148 të Kodit Zgjedhor, kundërshtimet e tilla duhet të parashtrohen brenda 48 orëve nga përfundimi i votimit dhe nga shpallja e rezultateve paraprake, respektivisht.

⁷⁷ Agjencia për Shërbime Audio dhe Audiovizuale Mediatike parashtroi tre raste në Gjykatën Themelore-1 në Shkup kundër televizioneve Alsat-M dhe Telma, duke pretenduar se i kanë shkelur rregullat e fushatës sipas nenit 76-b (3) të Kodit Zgjedhor për transmetimin gjatë votimit të hershëm të një fjalisë lidhur me COVID-19 të Ministrisë të Shëndetësisë dhe kundër Radiostacionit 1 për raportet e ministrave të brendshëm mbi parandalimin e krimeve të lidhura me zgjedhjet. Nuk u gjet asnjë shkelje.

⁷⁸ Paragrafi II.3.3 i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore kërkon që "Shtetet duhet të sigurojnë që shkeljet e të drejtave të njeriut dhe ankesat në lidhje me procesin zgjedhor të përcaktohen menjëherë brenda afatit kohor të procesit zgjedhor dhe në mënyrë efektive nga një organ i pavarur dhe i paanshëm".

Para pezullimit të procesit zgjedhor, KSHZ-ja njoftoi se kishte marrë një numër shumë të vogël kundërshtimesh, kryesisht lidhur me regjistrimin e votuesve që banonin jashtë vendit dhe me mediat.⁷⁹ Në 6 nga 15 kundërshtimet e parashtruara në Gjykatën Administrative, mediat e kontestuan pa sukses vendimin dhe udhëzimin e KSHZ-së për çmimet e reklamave politike në mediat transmetuese dhe refuzimin e aplikimeve të disa mediave për t'u regjistruar në Regjistër, që u jep të drejtë mediave të marrin mjete financiare publike (*Shih seksionin Mediat*).⁸⁰ Publikimet në ueb-faqen e KSHZ-së u kontestuan pa sukses në Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale (DMDHP), duke pretenduar se kanë zbuluar të dhëna personale.

Pas rifillimit të procesit, KSHZ-ja hodhi poshtë 42 kundërshtime për zhvillimin e hershëm të fushatës, sepse nuk ishin të mbështetura me fakte, pa i shqyrtuar ato në bazë të meritave. Vendimet ishin formaliste, identike në të gjitha rastet dhe nuk kishin arsytim thelbësor, me vendime formale të cilat merreshin pas skadimit të afateve, gjë që e pengonte mundësinë për mjet efektiv juridik.⁸¹ KSHZ-ja refuzoi 2.142 kundërshtime nga garuesit, kryesisht pasi përfaqësuesit e partive nuk u thirrën në parregullsi në protokollin e KZ-ve, që kërkohen si prova.⁸² Ankuesit pretenduan parregullsi gjatë votimit dhe numërimit, mospërputhje midis rezultateve paraprake të shpallura nga KSHZ-ja dhe rezultateve në protokollin e numërimit dhe të nxjerrjes së rezultateve të komisioneve zgjedhore, raste të votimit në emër të të tjerëve, përfshirje të njerëzve të vdekur në listën e votuesve dhe parregullsi për sa i përket vlefshmërisë së fletëvotimeve.

Rregullat për pranueshmërinë e kundërshtimeve duhet të përcaktojnë kërkesa të arsyeshme dhe diapazoni i provave të pranueshme nuk duhet të kufizohet tepër. Vendimet dhe veprimet e administratës zgjedhore duhet jenë të arsyetuara, duke siguruar garancitë e duhura për shqyrtimin efektiv të bazueshmërisë së kundërshtimeve.

Transparenca dhe efikasiteti i zgjidhjes së kundërshtimeve nga KSHZ-ja u penguan, pasi sistemi për parashtrimin online të kundërshtimeve që kërkohet nga Kodi Zgjedhor u lëshua në përdorim vonë gjatë procesit, pavarësisht nga rekomandimet e mëparshme të ODIHR për ta adresuar këtë çështje. Ueb-faqja për parashtrimin online të kundërshtimeve përfshinte rreth 400 ankesa, por transparenca e procesit u ndikua pasi ueb-faqja pushoi së funksionuari ditën e zgjedhjeve.

Për të siguruar parashtrim dhe trajtim efikas të kundërshtimeve, sistemi për parashtrimin online të kundërshtimeve duhet të vlerësohet dhe të ridizajnohet.

Për herë të parë, KZK-të kishin kompetencë të përcaktuar ligjërish për të shqyrtuar kundërshtimet për shkeljen e të drejtave të votimit gjatë votimit të hershëm dhe në ditën e zgjedhjeve dhe vendimet e tyre mund të apeloreshin drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative. Për shkak të juridiksionit të dyfishtë në ligj, KSHZ-ja shqyrtoi 21 raste të vendosura më parë nga KZK-të dhe në disa raste mori vendim të

⁷⁹ Të gjitha kundërshtimet u refuzuan. KSHZ-ja dhe Gjykata Administrative refuzuan gjithashtu një kërkesë nga Aleanca për Shqiptarët për t'i caktuar asaj kuotën për anëtarë të KZ-ve që vlenë për partitë e opozitës. Partia e kontestoi vendimin e KSHZ-së përsëri përpara zgjedhjeve të 15 korrikut, por pa sukses.

⁸⁰ Kundërshtimet nga një numër i stacioneve televizive kombëtare në lidhje me [Udhëzimin nr. 10-475/1](#) dhe [Vendimin nr. 10-476/1](#) u refuzuan si të papranueshme ose të pabazuara. Gjykata Administrative i pranoi katër refuzime të KSHZ-së. Shih seksionin Kundërshtimet dhe Ankesat të [Raportit të Përkohshëm](#) të vitit 2020.

⁸¹ Paragrafi II.3.3.b i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore thotë se "Procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalitete, veçanërisht për sa i përket pranimit të kërkesës së apelimit." Shih gjithashtu paragrafin 96 të Raportit të tij Shpjegues.

⁸² KSHZ-ja i konsideroi si të papranueshme 1.478 nga 1.982 kundërshtime nga *Levica*, pasi ato nuk ishin nënshkruar ose vulosur, dhe nuk i shqyrtuan ankesat e garuesve të parashtruara online. Kundërshtimet e mbetura të parashtruara nga garuesit e tjerë zgjedhorë u refuzuan si të pambështetura me prova.

kundërt.⁸³ Ekzistenca e mundësive paralele për zgjidhjen e kundërshtimeve e minon qartësinë ligjore dhe bie ndesh me praktikën e mirë ndërkombëtare.⁸⁴ Mekanizmi për të mbrojtur të drejtat e votës në ditën e zgjedhjeve nuk mundëson mjet efektiv ligjor për shkak të mungesës së trajnimit të KZK-ve dhe kryesisht ngaqë KZK-të nuk janë të përfshira në regjistrimin e votuesve dhe nuk janë në gjendje të ofrojnë ndonjë zgjidhje të mirëfilltë për ankuesit.

Mund të konsiderohet mundësia që t'i jepet juridiksioni një subjekti drejtpërdrejt të ngarkuar me regjistrimin e votuesve në nivelin lokal për të shmangur ngarkimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe për t'u siguruar që numri i madh i kundërshtimeve në lidhje me regjistrimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve të trajtohet në mënyrë efektive.

KSHPK-ja konstatoi shkelje në dy nga gjashtë kundërshtimet që pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore, njëra prej të cilave në fund u rrëzua nga Gjykata Administrative.⁸⁵ Gjykata Kushtetuese e hodhi poshtë një ankesë kundër një vendimi për regjistrimin e votuesve në një zyrë rajonale të KSHZ-së për shkak të mungesës së provave dhe e konfirmoi si të pabazë ankesën kundër vendimit të KSHPK-së për keqpërdorimin e burimeve administrative. Gjykata Administrative i hodhi poshtë të gjitha ankesat kundër vendimeve të KSHZ-së për parregullsi gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve, duke e pranuar mungesën e vërejtjeve në protokoll mbi parregullsitë si të vlefshme edhe për refuzimin e ankesave në lidhje me mospërputhjet midis rezultateve paraprake të përpunuara nga KSHZ-ja me protokollin e KZK-ve dhe KZ-ve.⁸⁶ Pandemia e KOVID-19 ndikoi në aftësinë e Gjykatës Administrative për të mbajtur seanca dëgjimore publike dhe për të formuar në kohë kolegjiomet gjyqësore për zgjidhjen e kontesteve në lidhje me zgjedhjet.

XIII. DITA E ZGJEDHJEVE

A. VOTIMI I HERSHËM

Më 13 korrik, 67 KZ të posaçme zhvilluan votimin në 57 komuna duke i vizituar në vendbanimet e tyre votuesit me KOVID-19 dhe ata që ishin në vetë-izolim. KZ-të e posaçme përfshinin tre punonjës shëndetësorë dhe dy përfaqësues të partive politike. Anëtarët e KZ-ve të posaçme u trajnuan të ndjekin protokollin specifik për mbrojtjen nga infeksioni dhe përhapja e KOVID-19, të cilat përfshinin veshjen e pajisjeve mbrojtëse personale (PMP), distancimin social dhe dezinfektimin në faza të shumta të procesit.⁸⁷

Më 14 korrik, KSHZ-ja e administroi votimin për të gjithë votuesit e regjistruar si të sëmurë ose të paaftë, për personat e zhvendosur brenda vendit dhe për ata që gjendeshin në institucionet e

⁸³ Rreth 30 kundërshtime kundër vendimeve të KZK-ve për të drejtat e votimit të votuesve që kishin të drejtë të votonin në shtëpi apo të atyre në vetë-izolim u kontestuan në KSHZ; KSHZ-ja konstatoi shkelje në 9 raste.

⁸⁴ Paragrafi II.3.3.c i Kodit të Praktikës së Mirë për Çështjet Zgjedhore dhe paragrafi II.3.3.97 i Raportit Shpjegues.

⁸⁵ Një rast ka të bëjë me përdorimin e një automjeti shtetëror për fushatë nga një ministër, tjetri ka të bëjë me shpërndarjen e paligjshme të fondeve publike gjatë fushatës, bazuar në një dekret qeveritar të detyrueshëm, për të cilin KSHPK-ja i filloi procedurat penale. KSHPK-ja hodhi poshtë tre kundërshtime që pretendonin keqpërdorim të burimeve shtetërore, pasi veprimet dhe vendimet e kontestuara ishin jashtë sferës së kufizimeve të periudhës së fushatës. Në një rast të iniciuar sipas detyrës zyrtare, KSHPK-ja gjeti indikacione të shkeljes së Kodit Zgjedhor në procedurat e emërimit të rektorit të Universitetit "Kirili dhe Metodi", por e ndërpreu rastin për shkak të kufizimeve kohore.

⁸⁶ Rreth 185 vendime të KSHZ-së për parregullsitë gjatë votimit dhe numërimit u apeluar, duke përfshirë 101 nga partia politike *Levica*, 75 nga Aleanca për Shqiptarët dhe AlternAtivA, nga dy vendime nga koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE-ja dhe nga partia Demokratët, nga një vendim nga USD-ja, "Maqedonia e Bashkuar" dhe koalicioni "Asnjëherë e Veriut - Vetëm Maqedoni" dhe nga MORO - Partia Punëtore.

⁸⁷ Nga 823 persona që kërkuan të votojnë më 13 korrik, 759 u regjistruan, dhe 723 nga ata votuan.

përkujdesjes, në burgje dhe në qendrat e paraburgimit. KZ-të e zakonshme zhvilluan votim mobil (të lëvizshëm) për t'u shërbyer këtyre votuesve në vendet e tyre, duke zbatuar masat mbrojtëse të KOVID-19.⁸⁸

Periodha e votimit të hershëm kaloi në përgjithësi në mënyrë të rregullt, pa incidente ose tensione të mëdha. Fletëvotimet e hedhura në të dy ditët e votimit të hershëm u shtuan në kutitë e votimit të vendvotimeve të njëjsteve zgjedhore të regjistruara të votuesve dhe u numëruan në fund të votimit të përgjithshëm më 15 korrik.

B. VOTIMI NË DITËN E ZGJEDHJEVE

Më 15 korrik, anëtarët e MPVZ-së së ODIHR-it vizituan një numër të kufizuar vendvotimesh për të vëzhguar procedurat e votimit dhe të numërimit.⁸⁹ Votimi në përgjithësi u administrua mirë, ku KZ-të shfaqën njohuri të mira të procedurave të votimit. U vërejtën disa raste të votuesve me dokumente të reja identifikimi që nuk ishin përfshirë në listat e votuesve. Çështje të vogla operationale u raportuan nga administrata zgjedhore.⁹⁰

Si administrata zgjedhore, ashtu edhe votuesit, i respektuan kryesisht protokollet shëndetësore, por disa ambiente të vizituara nuk kishin hapësirë të mjaftueshme për të mundur distancën e rekomanduar ndërmjet personave. Kur numri i votuesve të lejuar në një vendvotim ishte i barabartë me numrin e kabinave, radhët që pasuan rezultuan me turma në hapësira të përbashkëta, veçanërisht kur disa vendvotime ishin të vendosura në të njëjtin objekt.

Në shumicën e vendvotimeve të vizituara, personat me aftësi të kufizuara fizike nuk mund të hynin në mënyrë të pavarur. Shabllonet e Brejtit për fletëvotimet ishin në dispozicion për votuesit me shikim të dëmtuar, por një OJQ që punon për çështjet që lidhen me personat me aftësi të kufizuara - *Inkluziva* - e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se vetëm dy për qind e personave me shikim të dëmtuar janë të shkolluar për alfabetin e Brejtit.

Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, përmes masave praktike duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të siguruar qasje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit.

Në MPVZ-në e ODIHR-it u paraqitën disa pretendime për blerje votash në rajone të ndryshme të vendit, si në ditët para zgjedhjeve, ashtu edhe në ditën e zgjedhjeve, veçanërisht mes komunitetit rom. Në MPVZ u paraqitën gjithashtu edhe raportime për situata të tensionuara, raste presionesh mbi votuesit rreth vendvotimeve dhe mbushje të pretenduar të kutive të votimit, veçanërisht në lokacione në komunat e Kërçovës dhe të Sarajit, si dhe për një incident të dhunshëm të raportuar në Zajas. Më 23 korrik, MPB-ja në Prokurorinë Publike për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin ngriti akuzë penale kundër një këshilltari të Ministrisë të përkohshme të Punëve të Brendshme, për një kërcënim dhe ofendim të pretenduar të Kryeshefit të Sektorit të Punëve të Brendshme në Tetovë në ditën e zgjedhjeve. Mediat raportuan për arrestime nga ana e policisë për mbushje të pretenduar të kutive të votimit në komunën e Sarajit.

⁸⁸ Sipas KSHZ-së, nga 8.852 votues të regjistruar për të votuar si të sëmurë ose të paafte, votuan 8.325 (94 për qind); nga 1.657 votues të regjistruar në 13 institucione ndëshkuese, votuan 1.272 (77 për qind); nga 357 votues të regjistruar për të votuar në 17 institucione të përkujdesjes, votuan 234 (81 për qind) dhe nga 6 votues të regjistruar në Qendrën për personat e zhvendosur në brendi të vendit, nuk votoi askush.

⁸⁹ Në Haračinë, Gostivar, Kumanovë, Likovë, Shkup, Tetovë dhe zonat përreth këtyre komunave.

⁹⁰ Për shembull, një gabim shtypi në fletëvotimet në një vendvotim në komunën e Likovës rezultoi me ndërprerje të votimit.

C. NUMËRIMI, NXJERRJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE PARAPRAKE

Në këto zgjedhje, KSHZ-ja prezantoi aplikacionin e bazuar në internet “uVote”, për transmetimin elektronik të të dhënave periodike të pjesëmarrjes, si dhe të rezultateve paraprake. Ky aplikacion ofroi mundësinë që votuesit të shikojnë të dhënat e futura mbi pjesëmarrjen e kohëpaskohshme dhe rezultatet paraprake.

Më 25 shkurt, pas shpalljes fillestare të zgjedhjeve, KSHZ-ja shpalli tender publik për prokurimin e softuerit të ri dhe përmirësimin e softuerit ekzistues në lidhje me transmetimin e rezultateve të zgjedhjeve, në të cilin u përshkruan specifikimet e shërbimit të kërkuar. Komisioni Shtetëror i Ankesave për Furnizimet Publike (KSHAFP), pas ankesës së një konkurruesi, konstatoi se elementet e specifikimit rrezikonin konkurrencën e mirëfilltë.⁹¹ KSHZ-ja më pas i uli kriteret e kërkuara.⁹² Pas një procedure të re të furnizimit, më 29 qershor kompanisë lokale të TI-së, DUNA, iu dha kontrata për zhvillimin e aplikacionit të bazuar në internet për transmetimin e pjesëmarrjes dhe rezultateve përfundimtare - uVote.⁹³

Në procesin e zhvillimit të uVote, nuk u krye asnjë simulim i aplikacionit në shkallë të gjerë dhe mbikëqyrja e KSHZ-së mbi aplikacionin e zhvilluar nga DUNA ishte e kufizuar. KSHZ-ja e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se një test i operueshmërisë u krye dy ditë para zgjedhjeve, por asnjë raport mbi rezultatet e tij nuk iu paraqit KSHZ-së para ditës së zgjedhjeve. Administrata zgjedhore nuk pati asnjë trajnim për përdorimin e aplikacionit përtej udhëzimeve me shkrim.

Raportimi i të dhënave për pjesëmarrjen gjatë gjithë ditës u ndikua nga probleme të përkohshme teknike dhe KZK-të nganjëherë zgjodhi që t’i mbledhë të dhënat përmes thirrjeve telefonike dhe mesazheve me tekst. Pak pas mbylljes së vendotimeve dhe të dhënave të para të rezultateve paraprake, aplikacioni në internet ndaloi së shfaquri këto të dhëna paraprake; kjo ndërprerje u publikua shumë në media natën e zgjedhjeve. Kryetari i KSHZ-së raportoi një sulm kibernetik, i cili, sipas KSHZ-së, ndikoi në publikimin e rezultateve, pa ndikuar në procesin e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.⁹⁴ KSHZ-ja bëri përshtatje, duke i transmetuar drejtpërdrejt informatat nga baza e të dhënave të saj të pjesëmarrjes dhe të rezultateve në YouTube.

DUNA theksoi se përgjegjësia e tyre mbulonte performancën e aplikacionit, por jo sigurinë e serverit që u sulmua, për mirëmbajtjen e të cilit kujdeset KSHZ-ja. Departamenti i TI-së i KSHZ-së e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se një sulm në ueb-faqen e saj kryesore u përballua me sukses dhe se problemet me prezantimin e rezultateve duhet të kërkohej tek vetë aplikacioni. Sipas disa bashkëbiseduesve të MPVZ-së, të cilët ishin të përfshirë në këtë çështje, probleme të tilla teknike mund të jenë shkaktuar nga një kombinim i sulmeve të jashtme dhe i aftësive të pamjaftueshme të TI-së në KSHZ.

Problemet teknike ngritën dyshime, duke përfshirë edhe në mesin e partive politike dhe palëve të tjera të interesuara, në lidhje me rezultatet e shpallura. KSHZ-ja bëri një kontroll të kryqëzuar të protokolleve

⁹¹ KSHAFP-ja e informoi MPVZ-në e ODIHR-it se e kishte marrë vendimin vetëm në bazë të konkurrencës ekonomike, pa porositur ndonjë shqyrtim ekspert të ndikimit të vendimit mbi funksionalitetin në aspekt të TI-së, për shkak të mungesës së kohës dhe burimeve financiare. Shih [Vendimi 08-495/7 i Komisionit Shtetëror të Ankesave për Furnizimet Publike](#), 20 maj 2020 (në maqedonisht).

⁹² Disa bashkëbisedues të MPVZ-së konsideruan se kriteret e përshkruara në kushtet e reja të referencës ishin shumë të ulëta. Pasi që koha për një procedurë të re të plotë të tenderit publik do të kalonte përtej kalendarit zgjedhor, KSHZ-ja u përcaktua për procedurë të negociatave të drejtpërdrejta.

⁹³ Një konkurrues gjithashtu e kontestoi procedurën e negociatave të drejtpërdrejta, por ankesa u refuzua nga KSHAFP-ja më 8 korrik.

⁹⁴ Ueb-faqe të tjera, duke përfshirë përmbledhësin e lajmeve Time.mk, pësuan probleme të ngjashme.

përfundimtare në letër të KZ-ve nga të gjitha vendvotimet me rezultatet e ngarkuara në mënyrë elektronike në bazën e të dhënave. MPVZ-ja e ODIHR-it e vëzhgoi verifikimin që u bë në mënyrë të organizuar dhe profesionale. Përfundimisht, KSHZ-ja i shpalli zyrtarisht rezultatet paraprake me një vonesë prej rreth 20 orësh, në orën 19:30 më 16 korrik. Më 18 korrik, KSHZ-ja lëshoi një korrigjim të rezultateve për shkak të gabimeve të mëparshme teknike; megjithëse korrigjimi ishte shumë i vogël, ai i shtoi spekulimet e publikut për integritetin e rezultateve.⁹⁵

Për të siguruar integritetin e procesit zgjedhor, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse kibernetike. Strategjia duhet të përfshijë vlerësime të cenusshmërisë dhe taktika për zvogëlimin e ashpërsisë së problemeve, duke përfshirë ato që lidhen me kapacitetin institucional, softuerin dhe harduerin adekuat, masat e sigurisë dhe punonjës plotësisht të trajnuar dhe të përhershëm të TI-së në kuadër të administratës zgjedhore.

Më 22 korrik, një grup që e quan veten "AnonOpsMKD" mori përgjegjësinë për sulmin kibernetik, duke mohuar që KSHZ-ja të kishte qenë shënjestra e tij.⁹⁶ Më 28 korrik, Prokuroria Publike për Krimin e Organizuar hyri në KSHZ për të hetuar krimin e mundshëm në procedurën e furnizimit të zgjedhjeve softuerike. DMDHP-ja inicioi sipas detyrës zyrtare kontroll të jashtëzakonshëm në KSHZ dhe konstatoi shkelje të rregulloreve për mbrojtjen e të dhënave personale.⁹⁷

Më 25 korrik, KSHZ-ja shpalli rezultatet përfundimtare dhe ua dorëzoi certifikatat deputetëve të zgjedhur. Gratë përbënin 36 për qind të deputetëve të zgjedhur (43 nga 120 deputetë, 4 më pak krahasuar me legjislaturën e mëparshme).

KSHZ raportoi se 3.34 për qind e votave të hedhura ishin të pavlefshme. KSHZ-ja ia atribuon këtë numër relativisht të lartë prishjes së qëllimshme të fletëvotimeve nga votuesit në shenjë proteste dhe jo mosdijes se si ta shënojnë fletëvotimin. Kodi Zgjedhor kërkon që votuesi ta shënojë zgjedhjen e tij duke rrethuar numrin e parashtruesit të listës, por gjithashtu e njeh votën si të vlefshme nëse zgjedhja mund të përcaktohet në mënyrë të besueshme dhe të padyshimtë. KSHZ-ja lëshoi udhëzime që e ilustruan interpretimin e ligjit mbi vlefshmërinë e fletëvotimit.⁹⁸

KSHZ-ja i tha MPVZ-së së ODIHR-it se u përpoq t'i mbledhë të ndara sipas gjinisë të dhënat për ata që votuan, mirëpo informatat e marra nga KZK-të dhe KZ-të nuk kishin qenë të plota.⁹⁹

XIV. REKOMANDIME

Këto rekomandime ashtu siç janë paraqitur përgjatë gjithë raportit, ofrohen me qëllim që të përmirësohet zhvillimi i zgjedhjeve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe që të mbështeten përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet

⁹⁵ Sipas [një deklaratë të KSHZ-së të datës 18 korrik 2020](#), gjithsej 943.750 votues e ushtruan të drejtën e tyre për të votuar, që është për 1.416 më shumë se numri i shpallur fillimisht i votuesve, ndërsa numri i përgjithshëm i fletëvotimeve të pavlefshme u shtua për 98 dhe arriti në 31.564.

⁹⁶ [Intervistë me hakerin që qëndron pas sulmit ndaj Time.mk](#), IT.mk, 22 korrik 2020

⁹⁷ Gjetjet nga kontrolli në KSHZ-së janë në dispozicion në [ueb-faqen e DMDHP-së](#) (në maqedonisht).

⁹⁸ [Udhëzimi i KSHZ-së numër 10-689/1](#) i datës 3 mars 2020.

⁹⁹ Paragrafi 48d i [Rekomandimit të Përgjithshëm Nr. 23 i Komitetit të KB-ve për Eliminimin e Diskriminimit Kundër Grave i vitit 1997](#) u kërkon shteteve palë të sigurojnë "të dhëna statistikore, të ndara sipas gjinisë, duke treguar përqindjen e grave në krahasim me burrat që i gëzojnë ato të drejta". Paragrafi 40.13 i [Dokumentit të Takimit të Moskës i Konferencës mbi Dimensionin Njerëzor i KSBE-së](#), i obligon Shtetet të "sigurojnë mbledhjen dhe analizën e të dhënave për të vlerësuar në mënyrë adekuate, për të monitoruar dhe përmirësuar situatën e grave".

e mëparshme të ODIHR-it, të cilat mbeten për t'u trajtuar.¹⁰⁰ OSBE/ODIHR-i është i gatshëm që t'i ndihmojë autoritetet e Maqedonisë së Veriut për t'i përmirësuar edhe më shumë proceset zgjedhore dhe për t'i trajtuar rekomandimet që gjenden në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.

A. REKOMANDIMET PRIORITARE

1. Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet në mënyrë gjithëpërfshirëse për t'u harmonizuar si brendapërbrenda, ashtu edhe me ligjet e tjera përkatëse, për ta sjellë atë në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet ndërkombëtare dhe praktikrat e mira. Rishikimi duhet të bëhet në një procedurë publike, pas një procesi konsultimi gjerësisht gjithëpërfshirës dhe në kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të ardhshme në mënyrë që të garantojë qartësinë ligjore.
2. Për të siguruar stabilitetin dhe profesionalizmin e administratës zgjedhore, mandati i anëtarëve të Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve duhet të përcaktohet qartë nga Kodi Zgjedhor. Kodi duhet gjithashtu të parashikojë një procedurë të qartë dhe transparente të nominimit dhe emërimit të anëtarëve të KSHZ-së.
3. Në mënyrë që të sigurohet një kornizë rregullatore gjithëpërfshirëse, Kodi Zgjedhor duhet të rishikohet për të qartësuar dhe konsoliduar udhëzimet e hollësishme të përhershme mbi procedurat e regjistrimit të votuesve. Kërkesat në Kod duhet të korrespondojnë me funksionalitetin e Regjistrat Qendror të Popullsisë.
4. Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Enti Shtetëror për Revizion duhet të pajisen me burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për ta realizuar në mënyrë efektive mandatin e tyre gjatë periudhës zgjedhore.
5. Rregulloret për reklamat e paguara politike në media duhet të rishikohen, në mënyrë që të lejohet qasja e papenguar në media mbi baza jodiskriminuese.
6. Për të garantuar pavarësinë politike, transmetuesi publik duhet t'i nënshtrohet një sërë reformash, duke përfshirë ndryshimin e procedurës për zgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Këshillit Programor dhe uljen e varësisë së tij nga buxheti i shtetit. Reformat e mëtejshme të transmetuesit publik duhet të synojnë përmirësimin e cilësisë së përmbajtjes së prodhuar nga vetë transmetuesi, duke përfshirë edhe gazetarinë hulumtuese dhe atë analitike.
7. Korniza ligjore duhet të rishikohet për të eliminuar kufizimet e panevojshme të së drejtës për të parashtruar kundërshtime dhe ankesa zgjedhore në mënyrë që të ofrojë mjete efektive juridike.

¹⁰⁰ Në paragrafin 25 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), vendet pjesëmarrëse të OSBE-së u angazhuan "t'i ndjekin menjëherë vlerësimet dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet". Ndjekja e rekomandimeve nga [Raporti përfundimtar i ODIHR-it mbi zgjedhjet presidenciale të vitit 2019](#) është vlerësuar nga ODIHR-i si më poshtë: rekomandimi 22 është zbatuar plotësisht, ndërsa rekomandimet 1, 4-8, 10, 12, 14, 15, 18, 19, 21, 23, 24 janë zbatuar pjesërisht. Ndjekja e rekomandimeve nga [Raporti përfundimtar i ODIHR mbi zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit të vitit 2016](#) është vlerësuar nga ODIHR-i si më poshtë: rekomandimet 11 dhe 22 janë zbatuar plotësisht, rekomandimet 2, 8, 15, 18, 19 janë zbatuar kryesisht dhe rekomandimet 1, 3-6, 13, 16, 20, 21, 25-27 dhe 29 janë zbatuar pjesërisht. Shih gjithashtu [bazën e të dhënave të rekomandimeve zgjedhore të ODIHR-it](#).

B. REKOMANDIME TË TJERA

Sistemi zgjedhor dhe korniza ligjore

8. Për të siguruar barazinë e votës, legjislacioni duhet të parashikojë rishikimin periodik të kufijve të njësive zgjedhore nga një organ i pavarur. Kur ripërcaktohen kufijtë e njësive zgjedhore, kjo duhet të bëhet në kohë, në mënyrë transparente, të paanshme dhe gjithëpërfshirëse në bazë të një metodologjie të qartë dhe të qëndrueshme.

Administrimi i zgjedhjeve

9. Personeli thelbësor duhet të punësohet në Sekretariatit e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve në baza të përhershme. Kapaciteti i burimeve njerëzore të Sekretariatit duhet të përputhet me kompetencat që i janë dhënë Komisionit në bazë të Kodit Zgjedhor.
10. Nëse do të mbahet si mjet për zgjedhjen e anëtarëve të komisioneve zgjedhore, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës duhet ta përditësojë bazën e të dhënave të nëpunësve publikë, duke angazhuar institucionet përkatëse. Autoritetet mund ta konsiderojnë rishikimin e grupit të organeve shtetërore, nga të cilët angazhohen nëpunësit për të shërbyer në komisionet zgjedhore.
11. Në mënyrë që të sigurohet integriteti i procesit zgjedhor, KSHZ-ja duhet të zhvillojë dhe të zbatojë një strategji gjithëpërfshirëse kibernetike. Ajo duhet të përfshijë kapacitetin institucional, softuerin dhe harduerin adekuat, masat e sigurisë dhe punonjës plotësisht të trajnuar dhe të përhershëm të TI-së në kuadër të administratës zgjedhore.

Regjistrimi i votuesve

12. Dispozitat kushtetuese duhet të harmonizohen me standardet ndërkombëtare lidhur me të drejtën e votës së personave me aftësi të kufizuara intelektuale dhe psiko-sociale.
13. Në përputhje me rekomandimet e mëparshme të ODIHR-it, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet harmonizimit të të dhënave që ofrohen për regjistrin e votuesve, përkatësisht ndërveprimet të të dhënave të marra dhe standardizimit të sistemit të adresave. Duhet të kryhen revizione cilësore të regjistrit dhe ato duhet të bëhen publike në mënyrë sistematike.
14. Për ta lehtësuar ushtrimin e të drejtës së votës, mund të konsiderohen masa shtesë për t'u dhënë mundësi votimi votuesve që votojnë për herë të parë dhe që nuk kanë letërnjoftim, qytetarëve të cilëve u kanë skaduar letërnjoftimet pak para shpalljes së zgjedhjeve dhe qytetarëve që nuk i kanë marrë letërnjoftimet e reja para se të përditësohet lista e votuesve nga KSHZ-ja.

Regjistrimi i kandidatëve

15. Kufizimet në të drejtën për të kandiduar duhet të rishikohen për t'u siguruar që skualifikimi në bazë të dënimit të jetë proporcional me peshën e veprës.

Fushata zgjedhore

16. Duhet konsideruar mundësia e përshtatjes së periudhës zyrtare të fushatës me periudhën kohore për regjistrimin e garuesve, për t'u siguruar që rregullat e fushatës të vlejné në mënyrë konsekuente për të gjithë. Aktivitetet e zakonshme politike para periudhës zyrtare të fushatës nuk duhet të ndalohen dhe duhet të rregullohen.

17. Duhet të bëhen përpjekje të mëtejshme nga autoritetet për t'iu kundërvënë çdo forme presioni mbi punonjësit e sektorit publik, duke përfshirë edhe policinë. Funkionarët publikë duhet të informohen sistematikisht në lidhje me mekanizmat e zbatueshëm për të raportuar çdo rast presioni dhe të sigurohen se për këtë nuk do të kenë pasoja negative; rastet duhet të hetohen plotësisht dhe të ndiqen penalisht.

Financimi i fushatës

18. Dispozitat ligjore në lidhje me donacionet duhet të rishikohen në mënyrë që të harmonizohen kufizimet e donacioneve, për të siguruar transparencën dhe kufizimet e kredive të marra nga partitë politike për fushatën zgjedhore dhe për të krijuar një mekanizëm për të përcaktuar çmimin e tregut të kontributeve në natyrë.

19. Kodi Zgjedhor duhet të kërkojë që raportet e financimit të fushatës të dorëzohen dhe të publikohen në ditën e dorëzimit në format të njëtrajtshëm, të përshtatshëm për shqyrtim publik, dhe të shoqëruara me dokumentacionin financiar mbështetës. Sanksionet për dorëzimin me vonesë ose mosdorëzimin duhet të jenë efektive, proporcionale dhe dekurajuese. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare duhet të përshtatet për të qenë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

20. Rregullorja për mbylljen e llogarisë së fushatës duhet të sigurojë përfundimin e operacioneve financiare. Afati i fundit për dorëzimin e raporteve përfundimtare duhet të përshtatet për të qenë në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare.

Mediat

21. Dispozitat që rregullojnë lajmet e transmetuesit publik gjatë fushatës duhet të rishikohen, me qëllim që të sigurohet liria redaktuese, pluralizmi i pikëpamjeve dhe mundësitë e barabarta për garuesit.

22. Për të siguruar transparencën e pronësisë së mediave dhe të shpenzimeve të fushatës, mediat online të interesuara për të shitur hapësirën e tyre për reklama të paguara politike duhet të respektojnë disa kërkesa themelore të transparencës, duke përfshirë informacionin e verifikueshëm mbi pronësinë dhe financimin.

23. Partitë politike, si prodhuese të reklamave politike, duhet të jenë ligjërisht përgjegjëse për përmbajtjen e tyre.

Kundërshtimet dhe ankesat

24. Afatet për parashtrimin dhe zgjidhjen e kundërshtimeve mund të zgjaten që të mundësojnë përgatitje adekuate dhe vendim të peshuar mirë. Duhet konsideruar mundësia për t'i zgjatur afatet për shqyrtimin e rasteve të kundërvajtjes në lidhje me zgjedhjet, në përputhje me praktikën e mira. Duhet të sigurohen procedura të shkurtuara për hetimin e shkeljeve zgjedhore.

25. Rregullat për pranueshmërinë e kundërshtimeve duhet të përcaktojnë kërkesa të arsyeshme dhe diapazoni i provave të pranueshme nuk duhet të kufizohet tepër. Vendimet dhe veprimet e administratës zgjedhore duhet të jenë të arsyetuara, duke siguruar garancitë e duhura për shqyrtimin efektiv të bazueshmërisë së kundërshtimeve.

26. Për të siguruar parashtrim dhe trajtim efikas të kundërshtimeve, sistemi për parashtrimin online të kundërshtimeve duhet të vlerësohet dhe të ridizajnohet.
27. Mund të konsiderohet mundësia që t'i jepet juridiksioni një subjekti drejtpërdrejt të ngarkuar me regjistrimin e votuesve në nivelin lokal për të shmangur ngarkimin e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe për të siguruar që numri i madh i kundërshtimeve në lidhje me regjistrimin e votuesve në ditën e zgjedhjeve të trajtohet në mënyrë efektive.

Dita e zgjedhjeve

28. Në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, përmes masave praktike duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të siguruar qasje të plotë të personave me aftësi të kufizuara në procesin e votimit.

SHTOJCË: REZULTATET PËRFUNDIMTARE

	Numri ¹⁰¹		
Votues të regjistruar	1.814.263		
Votues që kanë votuar	943.750		
Vota të vlefshme	912.186		
Vota të pavlefshme	31.564		
Rezultatet			
Partitë/Koalicionet	Votat	Për qind	Mandat et:
Koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokratike e Maqedonisë (LSDM) me BESËN	327.408	35,89%	46
Koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE)	315.344	34,57%	44
Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	104.699	11,48%	15
Koalicioni i Aleancës për Shqiptarët (ASH) me Alternativën	81.620	8,95%	12
E Majta (Levica)	37.426	4,1%	2
Partia Demokratike e Shqiptarëve (PDSH)	13.930	1,53%	1
INTEGRA - Partia Konservative e Maqedonisë	12.291	1,35%	0
Unioni Demokratik Qytetar (UDQ)	3.555	0,39%	0
MORO - Partia Punëtore	3.245	0,36%	0
Zëri për Maqedoninë	2.802	0,31%	0
Maqedonia Unike	2.604	0,29%	0
Unioni Social Demokratik - Shkup (USD)	2.585	0,28%	0
Partia Jote	1.894	0,21%	0
Demokratët	1.558	0,17%	0
Partia Popullore e Romëve	1.225	0,13%	0
Numri i përgjithshëm i votave	912.186		120

¹⁰¹ Shih [shpalljen zyrtare të rezultateve përfundimtare nga KSHZ-ja](#).

RRETH ODIHR-IT

Zyra për institucione demokratike dhe të drejtat e njeriut (ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që i ndihmon vendet anëtare "të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, t'i përmbahen sundimit të ligjit, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të përforcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjithë shoqërinë" (Dokumenti i Samitit të Helsinkit të vitit 1992). Kjo pjesë njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

ODIHR-i, me seli në Varshavë të Polonisë, u krijua si Zyrë për Zgjedhje të Lira në Samitin e Parisit në vitin 1990 dhe filloi me punë në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar mandatin e zgjeruar, për të përfshirë edhe të drejtat e njeriut dhe demokratizimin. Sot ajo ka mbi 150 të punësuar.

ODIHR-i është organizata kryesore në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Çdo vit, ajo koordinon dhe organizon shpërndarjen e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse janë zhvilluar zgjedhjet në rajonin që e përfshin OSBE-ja në përputhje me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin kombëtar. Metodologjia e saj unike ofron një qasje të thellë në tërësinë e procesit zgjedhor. Me anë të projekteve për ndihmë, ODIHR-i i ndihmon vendet anëtare të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës në fushën e demokratizimit përfshijnë: sundimin e të drejtës, mbështetjen ligjore, qeverisjen demokratike, emigrimin dhe lirinë e lëvizjes dhe barazinë gjinore. ODIHR-i për çdo vit zbaton një numër programesh të dedikuara për mbështetje, me të cilat synohet zhvillimi i strukturave demokratike.

ODIHR-i po ashtu i ndihmon vendet anëtare të përmbushin detyrimet e tyre për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore që janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionet njerëzore. Kjo realizohet duke punuar me partnerë të ndryshëm për të kultivuar bashkëpunimin, për ndërtimin e kapaciteteve dhe për të ofruar ekspertizë në fushat tematike, duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, avancimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, mbikëqyrjen dhe raportimin për të drejtat e njeriut, të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e tolerancës dhe të mosdiskriminimit, ODIHR-i u ofron përkrahje vendeve anëtare në përforcimin e kapacitetit për t'iu përgjigjur krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të mostolerancës. Aktivitetet e ODIHR-it që kanë të bëjnë me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në këto fusha: legjislacioni, trajnimet për zbatimin e ligjeve, mbikëqyrja, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve ndaj krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si dhe aktivitete edukative për promovimin e tolerancës, respektit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i u ofron këshilla vendeve anëtare për politikatat e tyre që kanë të bëjnë me romët dhe sintit. Ai promovon ndërtimin e kapaciteteve dhe rrjetëzimin e komunitetit rom dhe atij sinti dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet e politikëbërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR-it realizohen në koordinim dhe në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare të OSBE-së, institucionet dhe operacionet e OSBE-së në terren, si dhe me organizatat e tjera ndërkombëtare.

Më tepër informacione mund të gjeni në ueb-faqen e ODIHR-it (www.osce.org/odihr).